


Jeta Myslimane

N Ë ★ A M E R I K Ë



Brenda: Njihuni me Familjen Taguri

TRYEZA E LËNDËS

JETA E FAMILJES

Foto: Kompaktësia..... 2

Në Amerikë familja vazhdon të jetë pjesë qendrore e traditës islamike.

Tagurët: Historia e një Familjeje..... 4

Si myslimanë të devotshëm, Dr. Jahja Taguri, e shoqja Salva dhe tre fëmijët e tyre bëjnë një jetë aktive në një qytet të vogël tipik amerikan.

Të Jetuarit në Dy Kultura..... 9

Foto: Fytyrat e Islamit..... 10

Fotografitë e bëra nëpër Amerikë dokumentojnë gamën e jashtëzakonshme të kombësive të myslimanëve që jetojnë në këtë vend.

BASHKËSITË MYSLIMANE

Foto: Jeta e Përditshme..... 12

Nga Miçigani në Nju Jork fotografët fiksojnë çaste nga jeta në bashkësitë e myslimanëve amerikanë.

Format e Imigracionit..... 14

Një dietare e shquar e Islamit në Amerikë përshkruan katër valët e dallueshme të myslimanëve që janë vendosur në Shtetet e Bashkuara.

Ku Jetojnë Myslimanët Amerikanë?..... 20

Një hartë e Amerikës tregon numrin e xhamive sipas shteteve. Shumica e tyre ndodhen në Kaliforni, por në çdo shtet është të paktën një.

Një Xhami në Masaçusets..... 22

Një profesor i Harvardit tregon se si një bashkësi myslimane, ngulimi së cilës nisi në fillim të viteve 1900, arriti të ndërtonte vetë një xhami.

ARSIMI

Foto: Shkollat Fillore Islamike..... 28

Këto foto tregojnë qartë se ekzistojnë shumë mundësi për arsimimin islamik të fëmijëve në Shtetet e Bashkuara.

Nxënësit Myslimanë në Kaliforni..... 30

Si reagues nxënësit myslimanë në shkollat e mesme publike të Kalifornisë Jugore ndaj ngjarjeve të 11 Shtatorit? Një gazetar i shtypit bisedon me adoleshentë të rastit.

Portreti i një Mësueseje..... 34

Ravia Ismail mëson nxënësit gjatë javës në një shkollë publike në Ohaio, kurse të dielën jep mësimë feje dhe arabisht në Qendrën e saj Islamike.



4



14



30

LARMIA E FALJEVE

Fakte Demografike..... 35

Një studim i kohëve të fundit mbi xhamitë në Amerikë jep të dhëna mbi pikëpamjet, përkatësitë etnike dhe shtrirjen e myslimanëve që jetojnë në Shtetet e Bashkuara.

Foto: Format e Lutjeve..... 36

Nga Medison Avenu në Nju Jork deri në një xhami në Nju Meksiko, kjo prerje tërthore fotografike tregon disa vende në të cilat myslimanët amerikanë bëjnë lutje.

Xhamitë në Amerikë..... 38

Arkitektura e xhamive shkrihet me peizazhin amerikan në një larmi të madhe formash krijuese.

Foto: Mbajtja e Ramazanit..... 42

Gjatë muajit të shenjtë myslimanët falen dhe janë të gatshëm t'u shpjegojnë fenë e tyre amerikanëve të tjerë.

NË BOTËN E PUNËS

Foto: Në punë..... 44

Biznesmen, dyqanxhi, doktor, punonjës social, shofer taksie – myslimanët sot zënë çdo punë që ofron ekonomia e SHBA.

Besimet dhe Sistemi Bankar..... 46

Një bashkësi myslimane në Minesota gjen rrugë të reja për të financuar shtëpitë dhe bizneset pa cënuar ndalimet islamike mbi pagimin e interesit.

NË RRJEDHËN QENDRORE

Në Fjalët e Presidentit Xhorxh U. Bush..... 50

Portreti i një Shkencëtari..... 51

Dr. Elias Zerhuni me origjinë algjeriane drejton Institutin Kombëtar të Shëndetit në SHBA, një nga qendrat kërkimore mjekësore më të mëdha të botës.

Foto: Njohja Zyrtare..... 52

Vitet e fundit myslimanët janë përfshirë gjerësisht në rrjedhën qendrore të jetës amerikane duke filluar që nga pulla e postës që përkujton Bajramin deri te lutjet që hapin një sesion të Kongresit të SHBA.

Muzika Rep Myslimane..... 54

A pajtohen vlerat myslimane me pulsën e qyteteve amerikane? Native Deen, një grup muzikor i njohur, mendon se po.



38



44



54

Sot Islami është një nga fetë që po njeh përhapjen më të madhe në Shtetet e Bashkuara. Sipas një studimi të kohëve të fundit, në Amerikë ndodhen 1 209 xhami, më shumë se gjysma e të cilave janë ndërtuar gjatë 20 vjetëve të fundit. Nga 17 gjer në 30 përqind e myslimanëve amerikanë janë të konvertuar në këtë fe.


Në qendër të jetës tradicionale amerikane si dhe të jetës së imigrantëve myslimanë relativisht më të rinj është familja. Shahed Amanullah, një inxhinier që jeton në San Fransisko, Kaliforni, thotë se «Në përgjithësi vlerat amerikane janë shumë në përputhje me vlerat islamike me fokusin e tyre te familja, feja, puna e palodhur dhe përkushtimi për të përmirësuar individin dhe shoqërinë.»

Ky libërth është një paraqitje e përmbledhur e një subjekti të shumanshëm, një përpyetje për të njohur nëpërmjet fjalëve dhe figurave gamën dhe pasurinë e jashtëzakonshme të mënyrës së jetesës së myslimanëve amerikanë. Kreun e tij e zë familja, kjo nyjë që gjendet në të gjitha kulturat.



1. Një grua myslimane që ka ardhur nga Libani më 1985 është vendosur në Diërborn, Miçigan, ku ka rritur edhe të pesë fëmijët e saj. Zona e Detroitit/Diërbornit përfshin një nga bashkësitë myslimane më të mëdha në Shtetet e Bashkuara.
2. Imam Omer Musa, në mes, me ndihmën e një përkthyesi kryen një ceremoni martese myslimane te shqiptarët etnikë në fshatin e refugjatëve në Fort Diks, Nju Xhërsi.
3. Një fëmijë katërvjeçar shikon të atin gjatë një shërbese lutjesh të mesditës në Qendrën Islamike në Lehi Valei në Uajtholl, Pensilvani.





4. Kjo familje myslimane amerikane jeton në Kaliforni.

Tagurët

HISTORIA E NJË FAMILJEJE

Nga Phyllis McIntosh

Tagurët e La Platës, një qytet i vogël në Merilendin Jugor afër Uashington D.C., në shumë aspekte përbëjnë një familje tipike amerikane. Babai është patolog në spitalin vendor dhe shërben edhe si zëvendësekspert mjekësor i kontesë Çarlz. Nëna vazhdon studimet për gradën Master në këshilltari në kolegjin Lojola të Baltimorës dhe shpreson të punojë si terapistë e licensuar në ndonjë shkollë apo klinikë private. Sikurse shumë prindër të periferisë, ata harxhojnë shumë kohë duke i çuar të tre fëmijët e tyre të moshave 8, 5 dhe 3 vjeç në kopsht, shkollë, në mësimet e vallzimit, të gjimnastikës dhe të Vajzave Skaute.

Tagurët janë edhe myslimanë të devotshëm dhe feja e tyre zë një vend qendror në jetën e tyre të mbushur me punë. Pavarësisht nga puna tejet aktive në spital, Dr. Jahja Taguri shkon me makinë te një xhami e afërt të paktën një herë në ditë për t'u lutur, nganjëherë duke marrë edhe fëmijët. Lutjet e ditëve të tjera i bën në zyrën e vet. Ai thotë se shumica e kolegëve të tij nuk janë myslimanë, po «kur shohin se dera ime është e mbyllur, ata e dinë se është koha e lutjeve dhe e respektojnë.» Gruaja e tij, Salva Omeish, që bën vajtje-ardhje mbi 270 kilometra për të ndjekur mësimet në kolegji, lutet në shtëpi përpara dhe pas shkollës.

SI U NJOHËN DHE U MARTUAN

Jahjai, 41-vjeçar, u rrit në Libi ku edhe ndoqi shkollën mjekësore. Më 1987 vendosi të bashkohej me të vëllanë në Shtetet e Bashkuara, ku përfundoi kualifikimin në specialitetin e tij në Spitalin e Fëmijëve të Pitsburg dhe në Universitetin Marshall në Virxhinian Perëndimore. Të njohur nëpërmjet miqve të tyre, Jahjai dhe Salva, tani 31-vjeçare, u martuan më 1992 dhe



u vendosën në Virxhinian Perëndimore ku qëndruan një vit dhe më pas shkuan në Birmingham, Alabamë, ku Jahjai kreu një stazh në Universitetin e Alabamës. Ata qëndruan një vit edhe në Selma, Alabamë, një qytet me rreth 20 000 banorë, që ka qenë në pararojë të lëvizjeve për të drejtat civile të afro-amerikanëve në vitet 1960.

Më 1996 ata shkuan në veri për të qenë më afër familjes së Salvës, po në vend që të vendoseshin në Uashington D.C., zgjedhën La Platën, Merilend, një qytet me popullsi prej 6 500 banorësh, 60 km në jug të tij. Ata ndërtuan një shtëpi në një lagje të qetë e të kamur disa kilometra jashtë qytetit. Sot shtëpia e tyre e madhe



2



3



6



5

1. Familja Taguri dhe një mbesë janë mbledhur në dhomën plot dritë për një portret.
2. Jashtë shtëpisë, Salva dhe Jahja Taguri luajnë me fëmijët e tyre.
3. Të gjithë kënaqen te këndi i shilarëseve.
4. Drekë në kuzhinën e Tagurëve është edhe një kohë për të qenë së bashku.
5. Pas drekës, të tre fëmijët e Tagurëve dhe kushërira e tyre shikojnë programe në TV sipas dëshirës.
6. Dr. Taguri ndihmon në ngritjen e tryezës pas drekës.

dhe moderne rrethohet nga drurë dhe një oborr i gjerë plot me mjedise me lodra fëmijësh.

Salva, edhe ajo e lindur në Libi, erdhi në Shtetet e Bashkuara në moshën 11-vjeçare kur i ati zuri punë në Bankën Botërore në Uashington D.C. Ajo u rrit në periferinë e Virxhinias të Uashingtonit, ku ndoqi shkollën fillore dhe kolegjin publik.

Duke kujtuar ato ditë, ajo thotë se duke e pasur të ndaluar që të shkonte në takime, vallzime apo festa shoqërore si shumica e shoqërisë së saj të shkollës, ajo nuk e ndjente shumë këtë kufizim. Duke banuar në një zonë të madhe metropolitane, ajo kishte shumë të njohur dhe miq myslimanë në shkollën e saj. «Ne vërtet i kishim të ndaluar disa gjëra,» thotë ajo, «por mendoj se nuk kishim ndonjë interes të veçantë për to.»

Si shumë gra të reja amerikane të martuara, pas martesës Salva e mbajti mbiemrin e saj, Omeish, në vend që të merrte atë të bashkëshortit. Dhe si shumë gra të tjera, ajo e balancon mirë dëshirën e saj për të ndjekur shkollën me kujdesin për familjen, e cila tani përfshin prindërit e Jahjait dhe një mbesë. Po pavarësisht nga aspiratat e saj profesionale, ajo thotë se «familja pa dyshim është e para.»

VENDIMI PËR TË MBAJTUR FEREXHE

Ndryshe nga shumë vajza myslimane të sotme në Shtetet e Bashkuara, të cilat mbajnë ferexhe në shkollën e mesme, deri përpara disa vjetësh Salva nuk mban-te. Mbajtja e ferexhesë «ishte një nga gjërat e fundit që doja të bëja,» thotë ajo. Arsyeja kryesore pse e mbaj tani është se Zoti na e kërkon një gjë të tillë. Ajo është një formë bindjeje ndaj Zotit dhe jo nënshtrim ndaj asaj çka na kërkon shoqëria lidhur me veshjen tonë.»

Megjithëse një pjesë e mirë e jetës shoqërore të familjes së tyre është e lidhur ngushtë me xhaminë, Tagurët kanë shumë miq dhe të njohur jomyslimanë. Me sa dinë ata, vetëm familja e tyre dhe



një fqinj, një kirurg ortoped me familjen, janë myslimanë në mëhallën e tyre. Ndër 80 e ca studentë të kolegjit Lojola që ndjek Salva, ajo është e vetmja myslimane.

Vajzat e tyre, Nuri në klasën e katërt dhe Juseri, që sapo ka hyrë në kopsht, kanë qenë në parashkollë të krishtera. Nuri tani shkon në një shkollë fillore publike ku thuajse të gjithë nxënësit janë jomyslimanë. Mësuesit dhe drejtorja e shkollës nuk kundërshtojnë kur vajza mungon në shkollë në festat myslimane. Mësuesja e Nurit e priti me kënaqësi Salvën në klasë për të zbuluar një stendë njoftimesh me fjalët «Gëzuar Bajramin» me rastin e kësaj feste myslimane që për shumë vjet të kaluara kishte rënë në të njëjtën kohë me Krishtlindjet.



2



3

1. Duke qenë një familje e devotshme myslimane, Tagurët luten në dhomë.
2. Dr. Taguri qëndron përpara xhamisë në La Plata, Merilend, ku bashkë me familjen merr pjesë në shërbesë.
3. Znj. Taguri, candidate për gradën Master në Kolegjin Lojola, merret me punë kërkimore në kompjuterin e saj.

Megjithëse shumica e shokëve të vegjël të fëmijëve të saj sot duket se nuk i vënë re dallimet fetare, Salva pohon se mund të jetë më e vështirë për fëmijët e saj në moshën e adoleshencës nga ç'kishte qenë për atë vetë në zonën e Uashingtonit. «Ne shqetësohemi, por jemi të palëkundur në besimin tonë», thotë ajo. «Kur shikojmë dallime, nuk mërzhitemi. Themi: «Në rregull, atë nuk e bëjmë dhe kaq.»»

Meqenëse xhamia vendore me rreth 40 familje është e vogël për të përballuar mësimet fetare, fëmijët Taguri i kalojnë fundjavët me gjyshërit apo shkojnë me makinë me shokët një orë larg për të frekuentuar mësimet islamike në Virxhinian Veriore. Edhe Nuri, e cila në moshën 8 vjeçe po mëson të bëjë lutjet e saj të përditshme, merr mësimet fetare nga një fqinjë një herë ose dy herë në javë.

A do të mbajnë perçe Nuri dhe Juseri? Tagurët theksojnë se vajzat e tyre do të vendosin vetë për këtë. «Këto gjëra nuk i detyron dot», thotë Salva. «Unë mund t'i detyroj vajzat që t'i mbajnë perçet në shtëpi, po në shkollë ato mund t'i heqin. Ne i mësojmë ato se çfarëdo që të bëjnë përpara syve tanë apo prapa shpinës sonë, Zoti i shikon.»

«Kur t'i kemi mësuar që ta shikojnë Zotin në çdo gjë që bëjnë dhe ta mbajnë atë në zemrat e tyre, atëherë besimi i tyre do të forcohet dhe ato do të duan t'i binden Zotit dhe urdhrave të tij qoftë në lutje, agjërim, bamirësi, apo qoftë duke bërë një punë të dobishme,» shton Jahjai. «Kur të arrijnë në këtë shkallë kuptimi, ato ndofta do të duan të mbajnë fereixe.»

TË MËSUARIT E ISLAMIT NËPËRMJET SHEMBULLIT

Edhe pse Tagurët e kanë kaluar jetën e tyre bashkëshortore në zonat më pak kozmopolite të Shteteve të Bashkuara, ata thonë se nuk kanë qenë objekt i intolerancës fetare. Ata besojnë fuqimisht në përhapjen e mesazhit të fesë së tyre nëpërmjet shembullit. «Unë nuk flas për Islamin kaq shumë,» thotë Jahjai, «por përpiqem t'u tregoj njerëzve se si duhet të jetë Islami në bazë të mënyrës se si e jetoj unë jetën time. Sapo fillojnë të më njohin, njerëzit më respektojnë për atë që jam.»

Edhe pas sulmit të 11 Shtatorit mbi Qendrën Botërore të Tregtisë dhe Pentagon, Tagurët thonë se ata personalisht nuk ndjenë armiqësi nga bashkëqytetarët e tyre amerikanë. «Të paktën në bashkësinë tonë ndodhi e kundërta,» thotë Jahjai. «Njerëzit tregoheshin shumë të kujdesshëm, na pyesnin a kishim ndonjë shqetësim dhe a na kishte rënë më qafë ndokush.» Salva, e cila dy



1



2

1. Muhameti, anëtar i më i ri në familjen Taguri, ndihmon të atin në pastrimin e kopshtit prapa shtëpisë.
2. Dr. Taguri vë në dukje simbolikën e zhvillimit të ri në qytetin e tij La Plata, pjesë të të cilit u shkatërruan nga një uragan në fillim të vitit.

ditë pas sulmeve filloi semestrin e vjeshtës në kolegji, u befusua nga merakut dhe i shoqeve të saj të klasës. «Ata më pyesnin se si ia kaloja dhe më thoshin se u vinte keq për të gjithë njerëzit nga Lindja e Mesme që shikoheshin me sy tjetër.»

Ajo që i zemëroi Tagurët, megjithatë, ishte përdorimi i shpeshtë i shprehjeve të tilla në media si «militant mysliman» dhe «terrorist mysliman». Salva vë në dukje se kanë ekzistuar edhe terroristë amerikanë vendas si Timothy Mëkuei, i cili vuri bombën në një ndërtesë federale në Oklahoma Siti më 1995 duke vrarë 168 vetë, apo i ashtuquajturin Unabomber që është përgjegjës për një sërë dërgimesh të bombave me postë. Shtypi, thotë ajo, nuk u referohet këtyre vrasjeve të motivuara politikisht si «militant i krishterë» apo «bombëvënës i krishterë.»

«Ta shikosh Islamin të portretizuar në këtë mënyrë është fyese» thotë ajo. «Fjala Islam do të thotë paqe. Kur ne vijmë në shtëpi, në vend që t'i themi «tjeta» njëri-tjetrit, i themi: «Paqja qoftë me ty». Islami ka të bëjë vetëm me paqen, por shumë njerëz nuk e kuptojnë këtë.»

Megjithëse njerëzit që bombarduan Qendrën Botërore të Tregtisë mund ta kenë bërë atë në emër të fesë, Tagurët thonë se ata pa dyshim nuk kanë pasur Zotin në zemrat e tyre. «Terroristi është terrorist, pavarësisht se në çfarë beson», pohon Jahjai. «Ne nuk duhet t'i lidhim akte të tilla me fenë.»

Ky çift u tërheq vëmendjen myslimanëve kudo në botë se edhe ato çka ata lexojnë apo dëgjojnë për Amerikën mund të mos jenë portretizime të sakta të amerikanëve apo të gjendjes së myslimanëve që jetoj-

në në Amerikë. «Ka shumë myslimanë në SHBA», thotë Salva. «Islami është feja që po përhapet më shpejt në këtë vend, pasi ka edhe shumë të konvertuar në të. Xhamia jonë në Birmingham frekuentohej nga rreth 80 përqind amerikanë biondë, me sy të kaltër. S'e kisha parë kurrë një gjë të tillë!»

Dhe më e rëndësishme, shton ajo, «është se ne mund ta ushtrojmë fenë tonë më lirisht këtu se ndofta në çdo vend tjetër të botës.»

«Nëse punon pa u lodhur, në Amerikë shpërblehesh në po atë masë», thotë Jahjai. «Është mrekulli të jetosh në një vend ku ka liri shprehjeje dhe drejtësi dhe ku Kushtetuta zbatohet për çdo individ. Ne jemi vërtet të lumtur që jetojmë në Amerikë.» ★

Phyllis McIntosh është shkrimtare e pavarur në zonën e Uashington D.C.

TË JETUARIT NË DY KULTURA

«Unë nuk e shikoj veten përmes identiteteve të ndara. Kuti që unë përdor për matje është feja ime; gjithçka tjetër ka vendin e vet. Identiteti im është: një palestineze amerikane që është myslimane.

– **Dr. Laila al-Marajati**, anëtare e Komisionit të SHBA për Lirinë Fetare Ndërkombëtare.

«Unë jo vetëm ndihem krenar që jam amerikan – që mbaj pasaportë amerikane dhe udhëtoj në të gjithë botën – por edhe që jam vetja ime, një mysliman që e ushtroj besimin lirisht, veçanërisht në Amerikë. Kjo do të thotë se unë zgjohem në mëngjes pa frikë dhe vij në shtëpi në mbrëmje pa frikë.»

– **Imam Jahja Hendi**, kapelan në Universitetin Xhorxhtaun, Uashington D.C.

«Unë e quaj veten fatlum që u jam ekspozuar të dyja kulturave. Fëmijët e mi kujtojnë lidhjet e ngushta të familjes sonë të madhe në Stamboll – ne nuk kishim televizor, ndanim së bashku çdo emocion. Në Shtetet e Bashkuara respektohet bota e individit. Unë gëzoj privatësinë dhe intimitetin, lirinë e shtypit dhe shprehjen politike.»

– **Nekva Ozgur**, drejtor shkolle, Pasadena, Kaliforni.

«Kërkimet tregojnë se vajzat përgjithësisht priren t'u qëndrojnë larg sporteve, sidomos kur u duhet të ndeshen me djemtë. Ne po punojmë që vajzat të mësojnë aftësi atletike pa u ndier të penguara nga veshjet e tyre konservatore. Ne duam që ato ta ndiejnë veten pjesë e jetës amerikane dhe jo si qenie të çuditshme. Nëna e një futbollisti mysliman që shikon ndeshjen e djalit të saj në anë të fushës, e veshur me fereixe, nuk duhet të jetë një gjë e rastit, por normë.»

– **Semen Isa**, arsimtar

«Kur njerëzit thonë se ne nuk kemi zgjedhur kurrë zyrtarë amerikano-myslimanë, unë them: «Po thonë të njëjtat gjëra që kanë thënë edhe për një katolik me emrin Kenedi që kandidonte për president.»

– **Suhail Khan**, anëtar i stafit kongresional

«Në të gjithë botën myslimanët po shikojnë me shpresa të mëdha bashkësinë umma në Shtetet e Bashkuara dhe Kanada. Dinamizmi, metodat risore, rigjallërimi studimor dhe rritja në tërësi përbëjnë shpresën e tyre për një rigjallërim islamik në të gjithë botën.»

– **Murat Uilfrid Hofman**, jurist mysliman

«Përherë e më shumë ata [myslimanët] po pretendojnë për një vend në sheshin publik. Tani për tani ata ende e shikojnë veten si një grup «i jashtëm» dhe jo si një grup «i qenësishëm» në jetën amerikane, por kjo do të vijë duke u ndryshuar ndërsa ata do të kalojnë në pozita në të cilat do të mund të afirmojnë trashëgiminë e tyre... Në historinë amerikane ekziston një gjedhe e kuqe/e bardhë/e kaltër që tregon se çdo grup imigrantësh ka zhvilluar një jetë kongregacionale dhe organizative të ndryshme nga ajo në vendet e tyre amtare. Shtëpitë e tyre të lutjes janë më shumë se thjesht shtëpi lutjesh, janë qendra për një gamë të tërë programesh të vëllazërisë e të bashkësisë, siç kanë bërë në shekujt e kaluar luterianët gjermanë, katolikët irlandezë e italianë dhe reformatoret holandezë.»

– **Devid Ruzen**, Seminari i Hartfordit

1



3



2



4



1. Me portret të përqendruar, ky mysliman irako-amerikan i bashkohet turmës që po falet në një xhami në Miçigan.
2. Në Shoqatën Islamike të Greitër Sharlotit, North Kerëljajne, anëtarët e trupës së Vajzave Skaute Myslimane bëjnë betimin e Skautistëve dhe në fund të takimit thonë një lutje myslimane.
3. Në Qendrën Islamike të Nju Meksikos gratë falen në një shërbesë ndërfetare lutjesh.
4. Dita e shenjtë e Bajramit shënon mbylljen e Ramazanit. Anëtarët e Qendrës Islamike të Amerikës në Diërborn, Miçigan, e kremtojnë këtë ditë me lutje.
5. Besimtarët myslimanë studiojnë në Qendrën Kulturore Islamike të Nju Jorkut.
6. Në Këlbës, Ohaio, një student maroken i informatikës në shtetin e Ohaio gjen një vend të qetë për të lexuar Kuranin ndërsa është duke pritur lutjet e mbrëmjes në xhaminë Omar Ibn Kahtab.
7. Zezakët myslimanë që jetojnë afër Maxhid ov Islam në Atlanta bëjnë pazar pas shërbesës së lutjeve të së Premtes. Shumë zezakë myslimanë që jetojnë në Shtetet e Bashkuara e kanë marrë fenë Islame në vitet 1960 dhe 1970.
8. Refugjatët kosovarë Selvete dhe Beqir dalin nga vendi i faljes pas shërbesës myslimane të martesës së tyre në fshatin e refugjatëve në Fort Diks, Nju Xhërsi. Një sërë agjencish dhe grupesh kontribuan në pajisjen e çiftit me veshje, tortë dhe unazat e martesës.



5



6



7



8



1



2



3

1. Në Shantili, Virxhinia, në periferi të Uashington D.C., një vajzë e vogël po argëtohet në karrusel në festën e Bajramit. Në këtë festë marrin pjesë me mijëra myslimanë.
2. Dy vullnetarë diskutojnë punën e tyre në AKSES, Diërborn, Miçigan, një nga qendrat më të mëdha ndër bashkësitë e vendit në shërbim të arabo-amerikanëve.
3. Një gjimnaziste myslimane merr pjesë në garën e stafetës në Filadelfia, Pensilvani.



4

5



4. Një vajzë arabo-amerikane shikon mbajtëset e çelësave në shitje në një rrugë në Bruklin, Nju Jork.
5. Besimtarët myslimanë qëndrojnë pranë një pike ku shiten sendiçe me suxhukë jashtë Qendrës Kulturore Islamike të Nju Jorkut.

FORMAT E IMIGRACIONIT

Nga Jane I. Smith

Myslimanët që jetojnë sot në Shtetet e Bashkuara përfaqësojnë një larmi lëvizjesh dhe identitetesh: imigrantë dhe vendas, sunitë dhe shitë, konservatorë dhe liberalë, ortodoksë dhe heterodoksë. Ndonëse shifrat e sakta të myslimanëve sot në popullsinë e SHBA janë të vështira për t'u nxjerrë, më shumë se gjysma e tyre janë anëtarë të brezit të parë, të dytë dhe të tretë të familjeve imigrante.

Megjithëse midis skllëvërve afrikanë që erdhën të punonin në plantacionet në jug të Amerikës në shekujt e 18-të dhe të 19-të kishte edhe disa myslimanë, shumë pak syresh e ruajtën identitetin e tyre islamik. Kështu që shumica e dijetarëve të Islamit përqendrohen tek imigrantët myslimanë që erdhën në Perëndim nga Lindja e Mesme në pjesën e fundit të shekullit të 19-të. Këto migrame të myslimanëve në Amerikë kanë ndodhur brenda një kuadri që mund të shihet si një seri periudhash të dallueshme, shpesh të quajtura «valë», ndonëse historianët jo gjithmonë bashkëpajtohen se nga se përbëhet një valë.

Ardhjet e para qenë ato ndërmjet viteve 1875 dhe 1912 dhe të ardhurit ishin nga zonat fshatare të Libanit, Sirisë, Jordanisë, Autoritetit Palestinez dhe Izraelit të sotëm. Kjo zonë, e quajtur Siria e Madhe, sundohej nga Perandoria Otomane. Shumica e burrave që vinin nga kjo zonë ishin të krishterë, por kishte edhe grupe myslimane. Meqenëse shumica qenë burra beqarë të motivuar ekonomikisht, ata punonin si argatë dhe tregtarë duke synuar të qëndronin vetëm për aq kohë sa të mund të fitonin paratë e duhura për të mbajtur familjet e tyre në vendet amtare. Disa iknin që t'i shpëtonin marrjes ushtar nga Turqia. Pak nga pak ata filluan të vendoseshin në pjesën lindore të Shteteve të Bashkuara, në Perëndimin e Mesëm dhe gjatë bregut të Paqësorit.

LIGJI I SHBA DHE VALËT E IMIGRACIONIT

Rënia e Perandorisë Bizantine pas Luftës I Botërore u bë shkak për një valë të re imigrimesh nga Lindja e Mesme Myslimane. Kjo është gjithashtu periudha



e sundimit kolonial perëndimor në Lindjen e Mesme nën sistemin e mandatit për të «qeverisur» tokat arabe. Lufta i kishte shkaktuar Libanit shkatërime të tilla sa që shumë njerëz detyroheshin të iknin thjesht për të mbijetuar. Një numër i konsiderueshëm myslimanësh vendosën të shkonin në Perëndim si për arsye politike, edhe ekonomike. Shumë prej tyre u bashkuan me të afërmit që qenë vendosur prej kohe në Shtetet e Bashkuara.

TË MYSLIMANËVE



Shumë familje siriane u vendosën në Nju Jork gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 19-të. Një vizatim nga W. Bengough në të majtë paraqet jetën dhe punët e përditshme në Uashington Strit në Manhatanin e Poshtëm në një lagje imigrantësh sirianë në këtë qytet më 1890.

Një ligj i ri i SHBA, që u miratua më 1924, e kufizoi këtë valë të dytë imigrimi duke vendosur «sistemin e kuotës të origjinës kombëtare» që i vinte kufij imigracionit në përputhje me origjinën kombëtare të popullsisë me origjinë të huaj në Shtetet e Bashkuara në vitin 1890 (që më vonë u ndryshua në 1920). Për shkak të këtij sistemi, lëvizja e myslimanëve për në Amerikë në vitet 1930 pësoi rënie të dukshme. Gjatë kësaj periudhe imigrantët qenë kryesisht të afërm të

Shënim: Jane Smith është profesoreshë e Studimeve Islamike dhe bashkëdrejtore e Qendrës Makdonald për Studimin e Islamit dhe të Marrëdhënieve Kristiano-Myslimane në Seminarin Hartford në Hartford, Konektikat. Ajo është bashkëredaktore e revistës *Muslim World*, e cila merret me studimin e Islamit dhe të Marrëdhënieve Kristiano-Myslimane. Ndër botimet e saj të fundit janë *Islami në Amerikë*; «Islami dhe Krishterimi» në *Historinë e Oksfordit mbi Islamin*; *Bashkësitë Myslimane në Amerikën e Veriut*; dhe *Misioni në Amerikë: Pesë Bashkësi Islamike në Shtetet e Bashkuara*.

personave me banim prej kohe në Amerikë, pasi, në bazë të sistemit, këta lejoheshin. Shumë prej atyre që tashmë jetonin në Shtetet e Bashkuara po fillonin të kuptonin se ëndrrat e tyre për t'u kthyer në vendin amtar ndofta nuk do të realizoheshin kurrë dhe se ata kishin nevojë për mbështetjen dhe strukturën që ua siguronin familjet e tyre.

Periodha e tretë e dallueshme e imigracionit, ajo nga viti 1947 në 1960, njohu përsëri një rritje në numrin e myslimanëve që vinin në Shtetet e Bashkuara, tani prej vendeve shumë më përtej Lindjes së Mesme. Ligji i Imigracionit dhe i Kombësisë i SHBA i vitit 1953 e kishte rishikuar formulën e kuotës që i caktohej çdo vendi të origjinës. Meqenëse ligji mbështetej në përqindjet e popullsisë në Shtetet e Bashkuara më 1920, gjatë kësaj periudhe imigrantët vinin kryesisht nga Evropa Perëndimore. Megjithatë filluan të vinin edhe myslimanë nga zona të tilla si Evropa Lindore (fillimisht nga Jugosllavia dhe Shqipëria) dhe Bashkimi Sovjetik, kurse një pakicë erdhi nga India dhe Pakistani pas ndarjes së nënkontinentit më 1947. Megjithëse shumë nga imigrantët e hershëm myslimanë qenë vendosur si në zonat fshatare, edhe në ato qytetëse të Amerikës, ata që erdhën me këtë valë të tretë përgjithësisht qenë me origjinë qytetare, kështu që u vendosën thuajse vetëm në qytetet e mëdha si Nju Jorku dhe Çikagoja. Disa ishin anëtarë të familjeve elitare të diskutshme në vendet e tyre. Ata qenë përgjithësisht më të familjarizuar me Perëndimin dhe më të arsimuar se paraardhësit e tyre dhe vinin me shpresën për të marrë shkollim dhe kualifikim më të mirë në Amerikë.

Vala e katërt dhe më e vonë e imigrantëve myslimanë ndodhi pas vitit 1965, kur presidenti Lindon Xhonson nxiti një projektligj për imigracionin që e shfuqizonte sistemin e vendosur prej kohe të kuotave në përputhje me origjinën kombëtare. Në bazë të sistemit të ri, parapëlqeheshin ata që kishin të afërm ndër banorët e SHBA si dhe ata që kishin aftësi profesionale të veçanta për të cilat kishte nevojë në Shtetet e Bashkuara. Ligji i ri që një akt sinjalizues në historinë amerikane, pasi për herë të parë që nga fillimi i shekullit të 20-të bëhej e mundur që një njeri të hynte në këtë vend pavarësisht nga origjina e tij ose e saj kombëtare. Pas vitit 1965, imigracioni nga Evropa Perëndimore filloi të binte ndjeshëm duke u kompensuar me një rritje korresponduese në numrin e njerëzve që vinin nga Lindja e Mesme dhe Azia. Më shumë se gjysma e imigrantëve në Amerikë prej këtyre rajoneve qenë myslimanë.

Deri në dekadat e fundit të shekullit të 20-të, shumica e myslimanëve vinin në Amerikë për arsye



1. Presidenti Lindon B. Xhonson firmos një projektligj të ri mbi imigracionin në Libërti Ajlënd në Nju Jork Harbër më 3 tetor 1965.
2. Fëmijë myslimanë me prejardhje afro-amerikane ose aziatike marrin pjesë së bashku në veprimtari në vitet 1960. Djemtë janë ulur përpara, vajzat pas.
3. Ditën e së krenës javore këta refugjatë shqiptarë etnikë janë ulur në shërbesën myslimane të lutjeve jashtë sallës së mensës në Fort Diks, Nju Xhersi, në maj 1999.

ekonomike ose shkollimi, kurse ata që kishin ardhur pas Luftës I Botërore kishin pasur si shkak trazirat politike në vendet e tyre amtare. Por trazirat politike kanë qenë një arsye kryesore edhe për shumë nga myslimanët e ardhur kohët e fundit në Amerikë. Ndër ngjarjet e veçanta që shkaktuan ardhjen e imigrantëve dhe të refugjatëve në Perëndim për të kërkuar shpëtim dhe azil kanë qenë disfata ushtarake e shteteve arabe nga izraelitët më 1967 dhe lufta civile në Liban dhe pasojat e saj.

Revolucioni Iranian dhe ardhja në pushtet e Imam Komeinit më 1979, e pasuar nga një luftë shkaktërrimtare prej gati një dekade mes Iranit dhe Irakut, bëri që mjaft iranianë të shkonin në Perëndim. Shumë u vendosën në Amerikë, sidomos në Kaliforni. Vlerësohet se sot në Shtetet e Bashkuara ndodhen rreth një milion iranianë. Që nga pushtimi i Kuvajtit nga Iraku dhe Lufta e Gjirit Persik, në këtë vend ka ardhur një numër i madh kurdësh. Për arsye luftërash politike dhe civile kanë ardhur rishtas edhe myslimanë nga Somalia, Sudani dhe vende të tjera afrikane, Afganistani, si dhe refugjatë myslimanë nga spastrimet etnike në ish-Jugosllavi.



Gjatë shumë dekadave, format e ndryshme të luftërave në Indi dhe Pakistan kanë inkurajuar shumë njerëz nga nënkontinenti që të kërkojnë mjedise më të qeta në Perëndim. Destinacionet më të parapëlqyera kanë qenë Anglia dhe Shtetet e Bashkuara. Megjithëse gjatë gjithë shekullit të 20-të imigrantët nga Pakistani, India dhe Bangladeshi kanë përbërë një përqindje të vogël të imigracionit mysliman në Amerikë, në dekadat e fundit numri i tyre është rritur ndjeshëm dhe sot ndofta arrin në më shumë se një milion. Myslimanët nga Pakistani dhe India, shumë nga të cilët janë profesionistë të zotë si doktorë dhe inxhinierë, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e grupeve politike myslimane në Amerikë si dhe në lidhësinë laik të bashkësive myslimane. Shumë e më shumë myslimanë po vijnë sot edhe nga vende si Indonezia e Malajzia, midis të cilëve ka njerëz mjaft të kualifikuar dhe që zënë pozita kyçe në Islamin Amerikan.

NJË BASHKËSI KOMPLEKSE

Myslimanët arabë sunitë dhe shitë vazhdojnë të jenë në përqindje të larta në bashkësinë islamike në Amerikë. Përgjithësisht ata janë shumë të arsimuar, profesionistë të suksesshëm dhe liderë në zhvillimin e një Islami Amerikan transnacional dhe transetnik. Përveç tyre, imigrantë nga Turqia, Evropa Lindore dhe një numër vendesh afrikane si Gana, Kenia, Senegali, Uganda, Kameruni, Guineja, Sierra Leone, Liberia, Tanzania dhe shumë të tjera, janë anëtarë të spikatur të bashkësive komplekse që përbëjnë umma-n amerikane. Imigrantët myslimanë jo vetëm që punojnë dhe

krijojnë marrëdhënie të efektshme bashkëpunimi mes tyre, por përballen edhe më çështjen se si të lidhen me anëtarët e lëvizjeve myslimane afro-amerikane. Imigrantët afrikane të kohëve të fundit nganjëherë e gjejnë veçanërisht të ndërlikuar përzierjen e fesë me etninë. Në ditët e para të imigracionit arab në Amerikë aty nga fillimi i shekullit, shumë myslimanë – si dhe brezat e parë të imigrantëve nga të gjitha kombësitë – shpesh, për të përmirësuar jetesën, bënë punë krahu, punë ambulate, tregti të vogla, punë në miniera. Shumë myslimanë arabë punonin si shitës ambulantë, një punë që nuk kërkonte shumë njohje të gjuhës, kualifikim apo kapital. Të tjerë kanë punuar si punëtorë krahu në brigada pune si ato që u përfshinë në biznesin e shtrimit të hekurudhave në Perëndim, i cili u zhvillua me shpejtësi. Kur gratë myslimane filluan të vinin pranë burrave imigrantë në Amerikë, edhe ato filluan të punësoheshin në fabrika e punishte ku punonin me orar të zgjatur në kushte shumë të vështira. Këto vite të para kanë qenë të vështira për myslimanët në Amerikë; shumë vuanin nga vetmia, varfëria, mosnjohja e gjuhës, mungesa e familjeve dhe e bashkëbesimtarëve.

Megjithatë, me kalimin e kohës, mjaft syresh filluan të kuptonin se kthimi në shtëpi nuk përbënte më një mundësi të dëshiruar, ndaj filluan të sistemoheshin në kontekstin amerikan. Në një mënyrë apo tjetrën filluan të martoheshin; ata të rinj që nuk mund të gjenin nuse myslimane i importonin ato nga vendi i tyre amtar ose i merrnin edhe nga fe të tjera. Ata filluan të punonin në biznese më të qëndrueshme duke vënë në punë aftësitë e tyre tradicionale në restorante, kafene, furra apo dyqane ushqimore. Mësuan anglisht, filluan

të bëheshin ekonomikisht më të pavarur dhe kërkonin myslimanë të tjerë për të formuar bashkësi në të cilat do të mund të fillonin edukimin fetar të fëmijëve të tyre.

Por jeta në Amerikë rrallë ka qenë e lehtë për myslimanët. Thuhet shpesh se Shtetet e Bashkuara janë një «komb imigrantësh», një «kazan shkrirjeje» për të gjitha racat dhe identitetet etnike, por paragjykimet fetare sigurisht që ekzistojnë, sidomos përpara epokës së lëvizjes për të drejtat civile në vitet 1960.

Për shumë vjet, pra, përgjigjja e shumë imigrantëve myslimanë ka qenë përpjekja për të fshehur përkatësinë e tyre fetare dhe etnike, për të ndërruar emrat që të tingëllonin sa më amerikanë dhe të mos merrnin pjesë në veprimtari apo të mbanin veshje që do t'i bënin të dukeshin «ndryshe» nga qytetarët e zakonshëm. Dora-dorës, ndërsa bashkësia myslimane vinte duke u zgjeruar e duke u bërë më e larmishme, më e arsimuar dhe shumë më e aftë për të kuptuar pozitën e saj, përpjekjet për t'u shkrirë me shoqërinë amerikane kishin filluar t'u hapnin udhë diskutimeve më të sofistikuara mbi rëndësinë e të jetuarit në Amerikë dhe, në të njëjtën kohë, edhe mbi ruajtjen e kulturës fetare të bashkësisë.

Pjesërisht konteksti për diskutime të tilla e kishte burimin te formimi i bashkësive myslimane sunite dhe shite në zonat fshatare dhe qytetëse amerikane dhe, në vitet e fundit, i organizatave kombëtare islamike që përfaqësonin forma shoqatash fetare, politike, profesionale dhe sociale.

TË VENDOSUR NË TË GJITHË TERRITORIN

Sot janë të pakta vendet në Shtetet e Bashkuara ku nuk gjenden myslimanë që jetojnë, punojnë dhe i çojnë fëmijët e tyre në shkolla publike; janë të zakonshme mjediset e dallueshme të faljes islame (xhami, shtëpi të rinovuara, madje edhe në rrugë kryesore).

Bashkësitë e para myslimane në Amerikë u formuan në Perëndimin e Mesëm. Në North Dakota myslimanët bënë lutje të organizuara qysh në vitet 1900; në Indiana kishte filluar aktivitetin një qendër islamike qysh më 1914, kurse në Sedër Repids, Ai-ovë, ndodhet xhamia më e vjetër ende në funksion. Qyteti Diërborn, Miçigan, në rrethinat e Detroitit, është prej kohe vatër e myslimanëve sunitë dhe shitë me prejardhje nga shumë vende të Lindjes së Mesme. Shumë syresh josheshin nga mundësia për të punuar në uzinën Ford Motor Company dhe pasi formojnë një ngulim, vinin edhe myslimanë të tjerë. Bashkë me të krishterët e Lindjes së Mesme, këta myslimanë

të Miçiganit formojnë koloninë më të madhe arabo-amerikane në vend.

Edhe qytete të tjera të mëdha në Amerikë kanë qenë vende të parapëlqyera për imigrantët myslimanë. Që në fund të viteve 1800, kantieret detare në Kuinsi, Masaçusets, në periferi të Bostonit, kanë qenë një burim për vende pune për myslimanët. Qendra aktuale Islamike e Nju Inglëndit, ëndrra e një grupi të vogël familjesh që u vendosën atje që në fillim të shekullit të 20-të, sot është një kompleks i madh xhamish në shërbim të njerëzve të biznesit, mësuesve, profesionistëve të tjerë, tregtarëve apo punëtorëve.

Islami është i pranishëm dhe i dukshëm në qytetin e Nju Jorkut prej më shumë se një shekulli. Në pjesën më të madhe të historisë së këtij qyteti, më i madhi në Shtetet e Bashkuara, spikat fakti se ai qenë vatër e një larmie të madhe grupesh etnike dhe popullsia e tij myslimane ka përfshirë tregtarë detarë, biznesmenë, argëtues, zyrtarë profesionistë apo pronarë të bizneseve të mëdha. Myslimanët e Nju Jorkut përfaqësojnë një spektër të gjerë kombësish thuajse nga të gjitha anët e botës. Në Nju Jork ka lulëzuar veprimtaria e ndërtimit të xhamive. Organizatat kombëtare islamike e gjejnë këtë qytet një vend veçanërisht të dobishëm për të zgjeruar veprimtaritë e tyre dhe atje kudo janë ngritur një numër i madh shkollash islamike fillore dhe të niveleve më të larta si dhe dyqane e biznese të zotëruara nga myslimanët.

Një vatër tjetër e hershme e imigrantëve myslimanë ka qenë Çikagoja, Ilinois, për të cilin thonë se në fillim të viteve 1900 kishte më shumë banorë myslimanë se çdo qytet tjetër në Amerikë. Sot myslimanët e Çikagos janë nga Lindja e Mesme, India, Azia Qendrore dhe Jugore si dhe nga shumë pjesë të tjera të botës. Ata punojnë aktivisht në dobi të fesë së tyre duke ofruar një larmi shërbesash për bashkësinë islamike si dhe duke bashkëvepruar me njëri-tjetrin apo edhe me jomyslimanët. Në Çikagon metropolitane ekzistojnë më shumë se 40 grupe myslimane.

Po ashtu, myslimanët në Los Anxhelos dhe San Fransisko të Kalifornisë kanë gjetur një klimë të favorshme për të lulëzuar. Edhe ata janë nga shumë zona të botës myslimane duke përfshirë edhe të ardhur të rinj nga Afganistani, Somalia dhe vende të tjera të Afrikës. Qendra Islamike e Kalifornisë Jugore është një nga entitetet më të mëdha myslimane në Shtetet e Bashkuara dhe stafi i saj i kualifikuar mirë është gjerësisht i njohur për shkrimet që ka bërë dhe për drejtimin e bashkësisë. Vetë konstrukti fiziko-funksional shumë mbresëlënës i qendrës siguron thuajse çdo shërbim për të cilin bashkësia e imigrantëve myslimanë ka nevojë.

Si banorë të Shteteve të Bashkuara, imigrantët e sotëm myslimanë vazhdojnë të përballen edhe me sfida, të cilat ata i zgjidhin në një sërë formash. Për shumë myslimanë amerikanë çështjet e identitetit, të veshjes dhe të kulturës janë veçanërisht të ndjeshme. Çështje të tjera madhore përfshijnë lidhjet ndërmjet grupeve të ndryshme etnike dhe racore myslimane si dhe ndërmjet myslimanëve të tjerë amerikanë; ku mund të sigurohet një edukim islamik për fëmijët; ku mund gjenden role dhe mundësi të përshtatshme për gratë. Shumë syresh janë duke e lënë pas fazën e të

qëndruarit larg rrymës qendrore të jetës amerikane dhe janë duke u hedhur në një pjesëmarrje shumë më aktive në arenat politike e shoqërore. Myslimanët amerikanë duket se tashmë po kalojnë në një fazë tjetër identiteti në të cilën këto kategori çështjesh po përballohen e po zgjidhen në forma të reja krijuese. Kjo pa dyshim do të sjellë si rezultat përfundimin e një Islami të vërtetë amerikan të endur nga pëlhura e shumë identiteteve kombëtare, racore dhe etnike, i cili ka filluar të shfaqet. ★


SHIFRA MBI POPULLSINË


Eshtë shumë e vështirë të përllogaritet numri i saktë i myslimanëve që jetojnë sot në Shtetet e Bashkuara. Myslimanët priren të japin shifra më të larta se studiuesit dhe demografët jomyslimanë; shifra e përllogaritur ndryshon gjerësisht – nga rreth 2 milionë sipas një studimi në afro 7 milionë sipas një tjetri.

Ekzistojnë shumë arsye për ndryshimet në përllogaritje. Së pari, për shkak se Kushtetuta e SHBA urdhëron ndarjen e kishës nga shteti, gjë që pasqyrohet në ligjet amerikane, formularët pyetësorë të Byrosë së Regjistrimit të Popullatës nuk u kërkojnë individëve të dhëna për fenë e tyre. Por as Shërbimi i Imigracionit nuk mbledh të dhëna mbi fenë e imigrantëve. Shumë xhami në Shtetet e Bashkuara nuk e kanë praktikë pune mbledhjen e të dhënave mbi anëtarësinë në to dhe rrallë mbajnë evidenca për numrin e frekuentuesve.

Siç shprehet dietari i fesë pranë Universitetit të Çikagos, Martin Marti, «Llogaritja e numrit të individëve bëhet nga dy burime. Një burim është që anketuesit të marrin në telefon shtëpitë gjatë orës së darkës dhe të pyesin: «Cila është feja juaj?» Burim tjetër janë liderët fetarë si në planin vendor, edhe kombëtar. Njerëzit që u përgjigjen telefonatave të intervistuesve mund të kenë arsye nga më të ndryshmet për t'u deklaruar se i përkasin këtij apo atij grupi, apo asnjë grupi. Por edhe njerëzit që japin të dhëna për madhësinë e kongregacioneve, sekteve dhe pasuesve të tyre mund të nisen nga arsye nga më të ndryshmet.»


Përfundimi është se nuk ka ndonjë numër zyrtar për myslimanët në Shtetet e Bashkuara dhe as ndonjë numër që të jetë përgjithësisht i pranueshëm nga të gjithë ata që e kanë studiuar këtë çështje.








NUMRI I XHAMIVE NË SHTETET E BASHKUARA SIPAS SHTETIT



Rritja e numrit të xhamive: 1986–2001
Gjashtë Shtetet në Krye




Një Xhami në Masaçusets

Nga Diana L. Eck

Historia e bashkësisë myslimane në Sharon, Masaçusets, në shumë aspekte është e ngjashme me përvojën e përgjithshme të myslimanëve në Amerikë. Ky mjedis i ri është një degë, ose zgjerim, i Qendrës Islamike të Nju Inglëndit në Kuinsi, në jug të qendrës së Bostonit dhe jo larg nga vendlindja e presidentit të gjashtë amerikan, Xhon Kuinsi Adams.

Kjo bashkësi nisi në fillim të viteve 1900, kur imigrantët vinin nga Siria dhe Libani për të punuar në kantieret detare të Kuinsit. Në fillim qenë më të shumtë të krishterët se myslimanët dhe më shumë burra se gra. Shpejt myslimanët u bashkuan për lutjet dhe ritet e veçanta. Në zonën e kantierëve detare qenë shtatë familje gjithsej. Muhamet Omar Auadi doli vullnetar si imam, drejtues i lutjeve. Më 1934 myslimanët formuan një organizatë kulturore, shoqërore dhe filantropike me emrin Arab American Banner Society. Ata mblidheshin në një shtëpi në South Strit në Kuinsi, organizonin mësimet fetare spontane për fëmijët e tyre, mblidheshin ditën e Premte për lutje dhe festonin dy festat e mëdha myslimane, Bajramin e Madh në fund të muajit të Ramazanit dhe Kurban Bajramin që është festa e sakrificës gjatë kohës së haxhillëkut në Mekë. Më 1962, tri dekada pas një strehimi të përkohshëm, liderët e kësaj bashkësie myslimane vendosën të ndërtonin një xhami në South Strit. Thuajse menjëherë pas përfundimit të ndërtesës më 1964, bashkësia filloi të zgjerohet me imigrantë të rinj. Gjatë dekadës midis viteve 1964–1974, ky grup i vogël u trefishua.

Në fillim të viteve 1980, bashkësia bëri një hap të madh përpara duke punësuar me orar të plotë imamin Talal Eid që kishte ardhur nga Libani dhe ishte diplomuar në Universitetin al-Azhar në Kairo. Ai sponsorizohej nga bashkësia e xhamisë së Kuinsit dhe Liga Botërore Myslimane. Eidi erdhi në Nju Jork me gruan dhe dy vajzat e tij bashkë me një imam tjetër



«Qendra Islamike e Nju Inglëndit, ku bëjnë pjesë mbi 25 kombësi të ndryshme, është një kopje e vogël e Kombeve të Bashkuara» thotë Imami Talal Eid.

libanez, edhe ai me familjen. Ata kishin pandehur se do të ishin fqinjë në Amerikë, por shpejt zbuluan se Nju Inglëndi dhe Nju Orlinsi ndodheshin mbi një mijë milje larg njëri-tjetrit.

Talal Eid ka mbi njëzet vjet që e udhëheq bashkësinë duke gjetur kohë edhe për punë pasuniversitare në Harvard Divinity School në vorbullën e një jete përherë e më të angazhuar. «Të jesh imam në Amerikë

është krejt ndryshe nga të jesh imam në Liban», thotë ai në një intervistë në Pluralism Project. «Atje roli im kufizohet brenda xhamisë dhe marrëdhënieve me bashkësinë, kurse këtu ai është një kombinim i tyre: unë drejtoj lutjet, merrem me arsimin, me këshillimet dhe me njerëz me prejardhje, kultura, kombësi e gjuhë të ndryshme. Qendra Islamike e Nju Inglëndit, ku bëjnë pjesë mbi 25 kombësi të ndryshme, është një kopje e vogël e Kombeve të Bashkuara.» Sot Imam Eidi ka përgjegjësi për më shumë se treqind fëmijë të regjistruar në programet arsimore javore dhe për dy kongregacione në Kuinsi dhe Sharon.

Roli i Imam Eidit është rritur jo vetëm për arsye të rritjes së kërkesave nga bashkësia e tij, por edhe nga klerikët në Amerikë në përgjithësi. Kjo do të thotë marrje mbi vete e dy roleve: vizita në spital dhe pjesëmarrje në takimet dhe dialogët ndërfaqetare të klerikëve. «Puna ime nuk ka të bëjë vetëm me edukimin e myslimanëve,» thotë ai, «por edhe me edukimin e jomyslimanëve, pasi të jetosh në një shoqëri pluraliste duhet të vendosësh marrëdhënie miqësore me njerëzit që kanë besime të tjera nga ty.» Si një nga liderët myslimanë më të shquar e më të njohur të Bostonit, Imam Eidi merr pjesë në tri ose katër shërbesa ndërfaqetare Falënderimi dhe ftohet shpesh për të folur në kisha, sinagoga apo organizata qytetare. Ai u përgjigjet pyetjeve në Bashkinë e Kembrixhit, vrapon për në xhaminë e Kuinsit për lutjet e së Premtes dhe më pas drejton një sesion mbi Islamin me infermieret në Spitalin e Fëmijëve. Detyrat ditore të Imam Eidit janë të lodhshme po aq sa ato të shumicës së pastorëve të qyteteve.

Si shumë bashkësi të tjera myslimane në SHBA, edhe bashkësia myslimane e Nju Inglëndit ka përjetuar frikë e dhimbje në rrugën e rritjes. Në mars 1990, një zjarr i madh përfshiu xhaminë në Kuinsi duke shkaktuar një dëm prej 500 000 USD. U mendua se zjarri ishte vënë me dashje, por hetimi nuk vërtetoi gjë dhe nuk u arrestua njeri. Kjo përvojë që shqetësuese për bashkësinë. Imam Eid rikujton: «Në të kaluarën, sa herë ndodhte një incident i pakëndshëm lidhur me myslimanët në Lindjen e Mesme ose në një pjesë tjetër të botës, njerëzit na drejtoheshin neve. Na bënë telefonime shqetësuese apo letra kërcënuese. Njerëz të zemëruar vinin për të demonstruar përpara Qendrës Islamike. Pastaj ra zjarri. Po të mblidhen retë në një vend tjetër të botës, shiu do të bjerë këtu te ne.» Një vit pas zjarrit, myslimanët bashkuan burimet dhe energjitë e tyre për të riparuar ndërtesën e shkatërruar – kubënë, një pjesë të mirë të sallës së lutjeve dhe mjedisin e mësimave.

Por edhe përpara zjarrit bashkësia e Kuinsit kishte qenë shumë ngushtë për vend në xhaminë në

Sauth Strit dhe kërkonte një ndërtesë më të madhe. Më 1991 grupi gjeti një ndërtesë të madhe në Milton, me mbi dy hektarë tokë përqark saj, në të cilën kishte qenë vendosur një qendër jezuite. Ajo dukej e përkryer për një qendër të re islamike. Shpejt në Milton u dëgjuan zëra që kundërshtonin, shprehnin frikë e madje dyshime. A nuk do të kishte lëvizje të mëdha njerëzish? A do të mjaftonte vendi i parkimit? A do të ishte kjo në pajtim me natyrën e popullsisë së Miltonit? Dr. Mian Ashraf, kirurg në Boston dhe lider i njohur i bashkësisë myslimane rikujton takimin me banorët e Miltonit. «Ata qenë shqetësuar se mos ne do të shkatërronim lagjen e tyre duke grumbulluar shumë njerëz. Një gazetar më pyeti: «Doktor, sa njerëz mendoni se do të vijnë këtu për t'u lutur?» I thashë: «Në ditët e festave tona të mëdha ndofta me mijëra.» Po dihet se ne kemi vetëm dy festa të mëdha në vit. Kështu që ditën tjetër në gazetë pashë titullin: «Mijëra myslimanë do të mblidhen për lutje në Milton.» U mërzita shumë.»

Bisedimet për blerjen e pronës vazhduan dhe ndërsa bashkësia islamike po finalizonte marrëveshjen lidhur me hipotekimin, një grup nga Miltoni e bleu pronën përpara saj për një milion e një çerek dollarë me para në dorë. «Kjo që një pilulë e hidhur,» thotë Ashrafi. «Pyesja veten: pse na e bënë këtë? A është e vërtetë që njerëzit na diskriminojnë? Unë nuk e doja këtë gjë, pasi gjithë jetën time askush nuk më kishte diskriminuar.» Disa njerëz në bashkësinë myslimane qenë të vendosur për ta çuar punën në gjyq dhe për të luftuar për të drejtën e fqinjësisë së mirë. Të tjerë nuk donin që të vendoseshim në një bashkësi që kishte shprehur një armiqësi të tillë. Kjo është një çështje e vështirë me të cilën janë përballur të gjitha bashkësitë e imigrantëve njëra pas tjetrës në qytete e lokalitete në të gjithë Amerikën, kanë bërë bisedime për të blerë pronë e truall dhe kanë ndeshur në kundërshtimin e banorëve. Bashkësia vendosi të mos bënte zhurmë për humbjen e kësaj mundësie, por ta hidhte shikimin në të ardhmen dhe të kërkonte një pronë tjetër.

Diana L. Eck është pedagoge në Harvard Divinity School në Kembrixh, Masaçusets. Që nga viti 1991 ajo drejton një ekip kërkimor në Harvard me objekt diversitetin e ri fetar në Shtetet e Bashkuara të quajtur Projekti i Pluralizmit.

Kjo ese është marrë nga libri i saj Një Amerikë Fetare e Re, që është botuar nga HarperSan Francisco nën siglën e HarperCollins Publishers, Inc., dhe që gjendet nëpër librari. Kopirajti © 2001 nga Diana L. Eck. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

1



1. Një grua e re bisedon lirshëm me një klasë vajzash të vogla në Akademinë Islamike të Nju Inglëndit.
2. Në Akademinë Islamike të Nju Inglëndit, një nga dy shkollat islamike në Masaçusets, një mësuese shikon nga dera nxënësit që luten.
3. Nxënësit e Akademisë në Sharon, Masaçusets, gëzojnë në një çast loje përpara lutjes së pasdites.

2



Për fat të mirë u paraqit rasti për të blerë një ish-fermë kuajsh në Sharon, një qytet i vogël prej 15 000 banorësh, më shumë se gjysma e të cilëve janë çifutë. «Më merr një burrë në telefon,» thotë Dr. Ashraf, «dhe më thotë: «Doktor, kam gjetur një vend të përshtatshëm për qendrën tuaj islamike. E lexova në gazetë se çfarë kanë dashur t'ju bëjnë. Ju doni të ndërtoni një shtëpi për falje dhe mendoj se mund t'ju ndihmoj.» Shkuam bashkë në Sharon. Ishte vënë në shitje një pronë me mbi 20 hektarë tokë në vend të qetë. Rashë menjëherë në dashuri me atë vend.»

«Po sikur fqinjët të na shkaktonin përsëri atë problem?» pyeti Ashrafi. «Ç'do të bëjmë?» Këtë herë bashkësia doli me një plan për t'ia bërë të njohur veten qytetit Sharon. Së pari, çdo fqinji që banonte në atë

rrugë i dhamë një videokasetë njohëse. «U thoshim njerëzve: «Po të keni pyetje, ejani të bisedojmë. Do të bëjmë takime. Do të ulemi. Do t'u përgjigjemi pyetjeve tuaja.» Energjia paraprake e bashkësisë duket se bëri punë dhe qyteti i Sharonit i hapi dyert për myslimanët e rinj. Rabini i Temple Israel, Beri Star, i tha Ashrafit: «Mendoj se ju do ta pasuronit qytetin tonë. Do të sillni gjëra të reja.» Stari bëri një takim me Shoqatën e Klerikëve të Sharonit dhe të gjithë patën mundësi të takoheshin me përfaqësuesit e bashkësisë myslimane. Klerikët e dhanë votën unanimisht për të mirëpritur Qendrën Islamike. Ata e botuan miratimin e tyre në gazetën lokale me titullin «Sharoni i Uron Mirëseardhjen Qendrës Islamike.»



3

Për herë të parë shkova në pronën e Sharonit kur po hidheshin themelet, në një ditë pranvere me shi më 1993. Ishte një pjesëmarrje ndërfaqetare, pasi kishin ardhur rabinë, peshkopë, pastorë dhe priftërinj, të gjithë me kapele pune, për të marrë pjesë tok me anëtarët e bashkësisë myslimane. Duke hedhur lopatat me dhe, shumë vetë thoshin se aty po hidheshin themelet për të gjitha bashkësitë fetare. Ne myslimanët kishim ngritur një tendë të madhe dhe të gjithë u futëm brenda për përshëndetjet dhe urimet e rastit. Më kujtohet veçanërisht një vajzë e re myslimane, një adoleshente që përfaqësonte të rinjtë myslimanë, e ulur në një karrige që paloset dhe që tha fjalët që myslimanët amerikanë i kanë thënë me mijëra herë duke u shpjeguar traditën e tyre fqinjëve të rinj: «Islam do të thotë paqe. Shpresoj

se do të vijë dita këtu në Nju Inglënd, e cila ka qenë përherë vatër e ideve të reja dhe e lëvizjeve të mëdha, kur besimet fetare nuk të përdoren kundër askujt, por do të jenë tregues i forcës morale të njeriut.»

Qendra e re u hap për herë të parë dy vjet më vonë në ditën e Bajramit të Madh, festa që shënon mbarrimin e Ramazanit. Ishte një ditë e ndritshme dimri pas një stuhie akulli e bore pak ditë pas Natës së Pushtetit. Fusha e ngrirë e fermës së dikurshme të kuajve u kthye në një parkim të gjerë për mijëra vetë që kishin ardhur për t'u falur. Dr. Ashrafi njoftoi jo pa krenari: «Sot Bajrami është festë zyrtare në Komënuelthin e Masaçusetsit. Falë përpjekjeve tona, Bajrami është një ditë pushimi e paguar për punëtorët myslimanë dhe festë fetare edhe për fëmijët tanë të shkollës. Ne duhet t'ua

1




1. Një grup grash mbledhen për të kremtuar mbarimin e Ramazanit në Qendrën Islamike në Nju Inglënd.
2. Megjithëse në të njëjtën dhomë, burrat dhe gratë luten veçanësisht gjatë Ramazanit në Qendrën Islamike të Sharonit.
3. Një mysliman i ri merr pjesë në ditën kombëtare të lutjes në Qendrën Islamike të Nju Inglëndit.

2



bëjmë të njohur njerëzve se Bajrami është festa jonë.» Ai lexoi me kënaqësi një letër të presidentit Klinton drejtuar bashkësisë myslimane. «Përshëndetje të gjithë atyre që po mbajnë muajin e shenjtë të Ramazanit. Duke qenë se dialogu po zëvendëson përballjen... Hilari dhe unë u dërgojmë përshëndetjet tona myslimanëve kudo që janë.»

Pas lutjeve të Bajramit, turma u derdh tatëpjetë kodrës me rrobat e festës – *selvar kamizes*, xhaketa kadifeje me temina e xhixha, gëzofe bojë trëndafili, veshje pambuku të ndritshme afrikane – një kongregacion festiv dhe i shumëngjyrshëm i ngazëllyer dhe i trallisur nga ajo trevë përrallore në dimër. «Nuk kam parë kurrë një Bajram të tillë në akull!» tha një djalosh nga Gambia e Afrikës. Në dhomën e pritjeve të shkollës në rrëzë të kodrës u servirën lëng frutash, kafe dhe petulla. «Eid Mubarak!» «Gëzuar Bajramin!» shkëmbeheshin urime në këtë mjedis besimtarësh myslimanë që sa vinin e shtoheshin, të lindur në mbi tridhjetë vende dhe që tani po farkëtonin një traditë myslimane amerikane.



Sot Qendra Islamike e Nju Inglëndit në të vërtetë është një mikrobotë e Islamit në Amerikë me brezat e saj të historisë, dhembjet e rritjes, përpjekjet për të vendosur ushtrimin e Islamit në një bashkësi islamike kulturalisht të larmishme dhe përpjekjet për të krijuar institucione islamike në truallin amerikan. Epika e ma-

rrëdhënieve të saj me fqinjët jomyslimanë është edhe pasqyrim i një përvoje më të gjerë – nga kërcënimet dhe sulmet me zjarrvënie deri te përpjekjet për zënien e një trualli dhe së fundi përpjekjet e suksesshme për të ndërtuar ura të reja lidhjesh me bashkësi fetare të tjera. ★



1

1. Nxënësit e klasës së parë mësojnë gjeografi në Shkollën Islamike të Oasisit në Ohaio, Klivlend, një shkollë pioniere në programin e financuar nga taksat.
2. Në shkollën fillore myslimane Al-Ghazaly në qytetin Xhërsi, Nju Xhërsi, një mësuese e klasës së tretë ndihmon nxënësit të përgatiten.



2



3. Nxënëset luajnë në sheshin e lojës në Shkollën Islamike në Greatër Lensing, Ist Lensing, Miçigan.
4. Një nxënës i klasës së dytë punon në orën e kompjuterit në shkollën fillore Al-Ghazaly qytetin Xhërsi, Nju Xhërsi.
5. Duke lexuar Sura të Shkurtra në anglisht, kjo nxënëse njihet me kapituj të rëndësishëm të Kuranit.

3



4



5

Nxënësit Myslimanë në Kaliforni

Nga Mary Rourke

Djemtë në plan të parë me duart të vëna rreth mesit, vajzat pas tyre me shalle që u mbulojnë flokët. Ky organizim u krye kaq natyrshëm sikur klasa ku ata qenë mbledhur të ishte xhami. Katërmbëdhjetë nxënës myslimanë rrinin gati për të filluar lutjet e mesditës.

Të rrethuar nga tryeza, libra, harta dhe projektorë diapozitivësh, grupi nuk i kushtoi vëmendje rrëmujës në klasë dhe asaj jashtë derës. Në shkollën e mesme në Palos Verdes Peninsula ishte kohë dreke dhe sheshi ziente nga gjallëria. Për këta djem e vajza, gjëja më e rëndësishme ishte Ramazani, periudha e shenjtë njëmujore gjatë së cilës myslimanët agjërojnë nga mëngjesi në mbrëmje. Këtë vit këta nxënës të moshës 14 gjer më 18 vjeç janë të vendosur të zbatojnë kërkesat e fesë së tyre nëpërmjet lutjeve në këtë mjedis të qetë publik.

Ata thonë se lutja në grup gjatë Ramazanit është një formë për të shprehur përkushtimin ndaj një feje që kohët e fundit është bërë më e diskutuara, më e kritikuar dhe më e mbrojtura në botë. «Kam bindjen se është e rëndësishme t'u tregoj njerëzve se ç'përfaqëson feja ime, veçanërisht në një kohë si kjo tani», tha nxënësi i vitit të parë Rehan Mutalib, 14 vjeç, prindërit e të cilit janë nga India. «Ne duhet t'i heqim stereotipet.»

Sulmet terroriste ndaj SHBA dhe breshëria e lajmeve në lidhje me Osama Bin Ladenin dhe rrjetin terrorist Al Kaeda ndryshuan jetën në mjediset e kësaj shkolle publike periferike të klasës shoqërore së mesme në të cilën, sipas të dhënave të zyrës së administratës, 285 nga 3 300 nxënës janë myslimanë. Rreth pesë vjet më parë, një grup i vogël nxënësish myslimanë të shkollës formuan Unionin e Nxënësve Myslimanë; kjo organizatë ka marrë një tingull të ri këtë semestër dhe sesionet e lutjeve të Ramazanit janë vetëm një pjesë e saj.

Unioni thuhet se nuk ka ekzistuar këtë vit, pasi nxënësit kanë qenë kaq të prekur e të tronditur nga ngjarjet në botë, saqë nuk arritën të bënin në afat regjistrimin e veprimtarive jashtëmësimore të shkollës. «Pas 11 Shtatorit ata ishin të tronditur», thotë Xhejms Meçling, pedagogu këshilltar i grupit, «dhe nuk po e mbledhin dot veten.» Meçlingu është kryetar i katedrës së studimeve fetare dhe i katedrës së historisë botërore në programin e së cilës bëjnë pjesë fetë kryesore. Kur grupi më në fund u mbledh, thotë Meçlingu, ai ishte më i angazhuar se kurrë më parë. «Vitin e kaluar në këtë grup bënin pjesë vetëm pesë ose tetë fëmijë, por edhe ata mblidheshin rrallë. Këtë vit kemi pasur një mesatare prej 20 nxënësish për mbledhje.» Një mbledhje tipike përfshin një bisedë nga një nxënës mbi një aspekt të fesë së tyre, lutjet dhe drekën.

Në shkollën Palos Verdes mblidhen rregullisht për lutje edhe dy rrethe të tjera: Klubi i Jetës së Re dhe Klubi i Shërbëtorëve të Krishtit, të dy të organizuar nga nxënës të krishterë. Sipas rregullave të Drejtorisë Arsimore të Kalifornisë, nxënësit e çdo feje janë të lirë të formojnë një grup me kusht që të mos e predikojnë fenë e tyre apo të përpiqen të konvertojnë të tjerë. Studimi i fesë është brenda kufijve të arsimit të shkollave publike me kusht që lënda të përfshihet në kontekstin e historisë dhe të kulturës dhe jo si lëndë fetare më vete.

Shumica e nxënësve myslimanë në shkollën Palos Verdes janë lindur në SHBA nga prindër të emigruar nga Irani, Egjipti, India dhe vende të tjera të Lindjes së Mesme dhe Azia. Sikurse shokët e tyre të shkollës, edhe ata përballen me trysnitë e zakonshme shoqërore dhe shkollore të bashkëmoshatarëve të tyre, por këtë semestër ata po ndeshen edhe me një mosbesim të përhapur ndaj myslimanëve.



1



2

1. Një nga mjetet që përdoren për të ndihmuar nxënësit e verbër në Shkollën e Mesme Klovis Uest në Kaliforni është globi special. Me ndihmën e mësuesit të gjeografisë, një nxënës i verbër nga Kuvajti mëson për botën.
2. Shabana ushtrohet në drejtshkrim në shkollën e Distriktit Hantington Biç në Kaliforni ku arabishtja mësohet në një program pilot.

Mary Rourke, shkrimtare e stafit në gazetën Los Angeles Times, është specializuar për shkrimet mbi fenë.

Kopirajti © 2001/Los Angeles Times Company



«Në fillim ata u hutuan», thotë Meçlingu. «Ditën e sulmeve kishin një ngërç në fyt. Qe shumë e rëndë për ta.» Disa nga nxënësit e planifikuar për t'u futur në Unionin e Nxënësve Myslimanë u njoftuan nga shokët e tyre myslimanë në shkollë që të bënin çmos për të mos tërhequr vëmendjen e të tjerëve. «Ata na thoshin: «Mos e bëj këtë», rikujton nxënësi i vitit të tretë Khosh Mansur, 16 vjeç, një nga liderët e Unionit të Nxënësve. Këshillën për të qëndruar të bashkuar na e dhanë nxënësit myslimanë jashtë unionit. «Ata mendojnë se Islami është një fe radikale.»

Ai e shikon këtë edhe në një aspekt tjetër. «Ka shumë nxënës myslimanë në shkollë», thotë ai. «Disa nga ne gjykan se është e rëndësishme që atë çka beson ta ushtrosh në bashkësi si shenjë uniteti». Megjithatë, se prejardhjet e tyre ndryshojnë, këta nxënës janë nga familje fetare dhe ushtrimi i fesë nuk është diçka e re për ta. Megjithatë, këtë vit Ramazani i ngarkon ata me përgjegjësi dhe angazhime më të mëdha.


Qysh ditën e parë, gjatë seancës së lutjeve, disa nga nxënësit recituan vargje nga Kurani në arabisht. Një prej tyre, Zejad Masarani, 16 vjeç, e ka mësuar këtë gjuhë në shtëpi. Ia ka mësuar e ëma. Ai e mban gjallë

duke shikuar programe televizive në arabisht. Ai dhe disa nxënës të tjerë thanë se atyre u takon që t'i dalin në mbrojtje sa më parë besimit të tyre. Ata vunë në dukje edhe pasiguritë që u shkaktohen adoleshentëve kur vihen në shënjestrën e gjykimit të nxënësve të tjerë.

«Unë dua që të dukem një adoleshent i rregullt në shkollë», tha Mutalibi. «Por dua që të pranohem edhe si mysliman, jo si diçka ndryshe apo e gabuar.» Ai tha se merr pjesë në lutjet e Ramazanit në shkollë, sepse nuk i bën dot vetë. Kurse nxënës të tjerë thanë se ndihen më të sigurt kur luten së bashku. «Ne duam forcim të moralit», tha Mansuri. «Shumë myslimanë këtu dhe në botë po kalojnë vështirësi. Ne duam që ata ta dinë se nuk janë vetëm.»

Të pyetur për Bin Ladenin dhe al Kaedën disa nga nxënësit u skuqën. «Unë nuk mendoj se ka fundamentalistë myslimanë», u përgjigj me pasion Masarani. «Ka qeveri dhe ekstremistë të zvetënuar.»

Mutalibi qe më objektiv. «Unë i shikoj talebanët dhe Osama Bin Ladenin jo si myslimanë që e ushtrojnë fenë me korrektësi, por si njerëz që e keqkuptojnë fenë», tha ai. «Shumica e myslimanëve përpiqen ta ushtrojnë fenë me themel. Edhe unë.»



1. Në shkollën e vajzave Uestrixh në Pasadena, Kaliforni, një trajniere ndihmon një lojtare të re në gjuajtje të lira gjatë një fushimi sportiv dyjavor të vajzave myslimane.
2. Një basketbollist mysliman i një shkolle të mesme thyen agjeringun pas përfundimit të diellit.

Muajin e kaluar Madi Gorob, 14 vjeçe, prindërit e së cilës imigruan në SHBA nga Irani, mori një vendim të rëndësishëm për veshjen e saj. Gratë nuk duhet të mbajnë vetëm shall koke, gjë që shihet si shenjë modestie dhe si sinjal se ato përpiqen të jetojnë sipas mësimave myslimane, të cilat, ndër të tjera, ndalojnë seksin jashtë martese dhe alkoolin. Ndryshe nga shumica e vajzave, të cilat në lutjet e Ramazanit vinin me veshje perëndimore dhe gjatë lutjeve mbulonin vetëm flokët, Gorobi, «kur vuri perçen», e ndryshoi krejt të gjithë veshjen e saj. Tani ajo vesh një fund të gjatë dhe një bluzë me mëngë të gjata për ta mbajtur trupin e saj tërësisht të mbuluar.

«U betova se kurrë nuk do të mbaja vetëm perçen», tha ajo. Sa për veshjen që ia mbulon të gjithë trupin, ajo shtoi se «qëllimi im ka qenë që të vishja rroba të masës dy, të shkoja në takime dhe vallzime. Por tani

dua të identifikohem si myslimane. Këtu nuk ka asgjë për të ardhur turp.»

Gorobi dhe nxënës të tjerë në Unionin e Nxënësve Myslimanë thanë se shumica dërrmuese e nxënësve myslimanë në shkollë po largohen nga gjithçka që i identifikon ata si të tillë. «Ata po bëjnë çmos që të përshtaten, kështu që nuk i dallon dot myslimanët nga të tjerët», thotë Dania Arafeh, 14 vjeçe, një nga shoqet e ngushta të Gorobit.

Arafehu filloi ta mbulonte kokën me shall tre vje më parë. E lindur në SHBA nga prindër me origjinë egjiptiane dhe palestineze, ajo i quan gratë si gurë të çmuar dhe për këtë citon edhe Kuranin. «Nëse gruaja e mbulon pamjen e saj nuk do të thotë se ajo e ul veten», thotë Arafehu. «Këtë e bën për t'u mbrojtur. Pse duhet që ajo të jepet kaq shpejt?»

Për dekada të tëra myslimanët progresistë dhe liderë të tjerë myslimanë në SHBA i kanë këshilluar imigrantët e rinj që për t'u integruar më mirë në shoqërinë amerikane, rrobat fetare t'i veshin në shtëpi, kurse jashtë saj të veshin rroba të stilit perëndimor. Pasioni i Arafehut për veshjen tradicionale sugjeron një vizion tjetër për të ardhmen. «Do të ishte shumë gjë e këndshme sikur njerëzit e çdo feje të vishnin rrobat e tyre fetare», thotë ajo. «Kështu do të mësonim më shumë nga njëri-tjetri.»

Ndërkohë që Arafehu dhe Gorobi bisedonin jashtë klasës së Meçlingut pas ditës së parë të lutjeve të Ramazanit, Behare Sheigan-Fatemi u prezantua tek ato. Ajo e kishte ndjekur seancën e lutjeve mënjandë, duke i vështruar.

«Kam katër muaj që ardhur këtu nga Irani», u tha vajzave ajo. «Nuk njihja asnjë mysliman, kështu që e fsheha veten dhe zakonet e mia.» Bluza dhe xhinset e saj i vërtetonin më së miri fjalët që thoshte. Në Iran gratë duhet të mbajnë ferexhe dhe rroba që t'u mbulojnë pamjen. «Po habitem shumë», tha ajo duke qeshur. «Kur je vetëm, je një pikë ujë. Kurse këtu, bashkë me kaq shumë nxënës myslimanë, bëhesh pjesë e detit, bëhesh një pikë nga shumë pika të tilla.»

Sheigan-Fatemi nuk ishte në gjendje të thoshte nëse do të mbante veshjen tradicionale myslimane në SHBA. Ajo gjithashtu nuk mund të thoshte nëse do të bashkohej përsëri me nxënësit për lutjet e Ramazanit.

«Po habitem», tha ajo. «Më duhet njëfarë kohe.»★

«Unë jap mësim në shkollat publike amerikane. U jap mësim edhe fëmijëve të mi në shkollën islamike.»

–Rauia Ismail, Mësuese, Toledo, Ohaio.



«Jam mësuese në shkollën publike në Toledo, Ohaio, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. U jap mësim edhe fëmijëve të mi në shkollën e së shtunës, shkollë islamike.

Jam lindur në Beirut, Liban, dhe kam ardhur në Shtetet e Bashkuara më 1984. Kam katër fëmijë të bukur. Vendosa të bëhesha mësuese sepse më shumë se gjithçka më pëlqen të punoj me fëmijët.

Në Qendrën Islamike u jap fëmijëve mësim feje rreth një orë, një orë u jap arabisht, pastaj ata hanë drekë dhe më pas bëjmë lutjet së bashku. Kjo është diçka që unë e mendoj si mënyrën e vetme të jetesës për mua dhe familjen time. Të qenit mysliman për mua është gjithçka.

Unë mbaj ferexhe në shkollën publike ku jap mësim. Fëmijët më bëjnë shumë pyetje. Nuk ka ndodhur që ndonjë fëmijë të më thotë se kjo është e çuditshme apo diçka të tillë. Ata, por edhe prindërit e tyre, e pëlqejnë faktin se kjo është njohje me një kulturë tjetër dhe një fe tjetër.

Në lagjen time unë vë re se të gjithë jomyslimanët interesohen shumë për t'i edukuar fëmijët me vlerat e familjes, gjë që edhe unë e bëj. Pas 11 Shtatorit, unë nuk kam vënë re ndonjë paragjykim në lagjen time.

Në shkollën publike punoj shumë për t'i bërë fëmijët të kuptojnë se feja ime është shumë e ngjashme me fenë e tyre dhe gjëja më e rëndësishme është që ne të punojmë mbi bazën e ngjashmërive që kemi, se sa të ndryshimeve.

FAKTE DEMOGRAFIKE

- ★ Xhamitë në Shtetete Bashkuara: **1 209**
- ★ Myslimanëamerikanë të lidhur me një xhami: **2 milionë**
- ★ Rritja e numrit të xhamive prej vitit 1994: **25 përqind**
- ★ Raportii xhamive të ndërtuara prej vitit 1980: **62 përqind**
- ★ Numri mesatar i myslimanëve të lidhur me një xhami në Shtetet e Bashkuara: **1 625**
- ★ Frekuentuesitë e xhamive që janë të konvertuar: **30 përqind**
- ★ Myslimanëamerikanë «që janë shumë dakord» se duhet të marrin pjesë në institucionet amerikane dhe në procesin politik: **70 përqind**
- ★ Xhami në SHBA që frekuentohen nga një grupi vetëm etnik: **7 përqind**
- ★ Xhami në SHBA që kanë anëtarë aziatikë, afro-amerikanë dhe arabë: **rreth 90 përqind**.
- ★ Origjinatetnike të pjesëmarrësve të rregullt në xhami në SHBA:

Azia Jugore (pakistanezë, indianë, bangladeshas, afganë) = 33 përqind

Afro-amerikanë = 30 përqind

Arabë = 25 përqind

Afrika Nën-Sahariane = 3,4 përqind

Evropianë (boshnjakë, tartarë, kosovarë, etj.) = 2,1 përqind.

Amerikanë të bardhë = 1,6 përqind


Azia Juglindore (malajzianë, indonezianë, filipinas) = 1,3 përqind

Karaibet = 1, 2 përqind

Turqia = 1,1 përqind

Irani = 0,7 përqind

Vendet Hispanike/Latine = 0,6 përqind



- ★ Xhamitë në SHBA që pohojnë se ndjekin me rigorozitet Kuranin dhe Sunën: **mbi 90 përqind**
- ★ Xhamitë në SHBA që pohojnë se Kurani duhet të interpretohet duke pasur parasysh qëllimet e tij dhe rrethanat moderne: **71 përqind**
- ★ Xhamitë në SHBA që japin njëfarë ndihme nevojtarëve: **rreth 70 përqind**
- ★ Xhamitë në SHBA me shkollë me orar të plotë: **mbi 20 përqind**


Informacioni i mësipërm është marrë nga «Xhamitë në Amerikë: Tablo Kombëtare», një studim i botuar në prill 2001.

Ai është pjesë e një studimi më të gjerë mbi kongregacionet amerikane i quajtur «Bashkësitë Fetare Sot», i bashkërenduar nga Instituti Hartford për Kërkimet Fetare pranë Seminarit Hartford në Konektikat. Organizatat myslimane që e kanë bashkësponsorizuar studimin janë Këshilli mbi Fetë Amerika-no-Islamike, Shoqata Islamike e Amerikës së Veriut, Shërbesa e Imam W. Deen Muhammed dhe Rrethi Islamik i Amerikës së Veriut.

Në këtë botim grafikët janë marrë nga i njëjti studim.



1



2



3

1. I themeluar 20 vjet më parë në veri të Nju Meksikos dhe i ndërtuar sipas stilit afrikano-verior, Dar al Islami përfshin një xhami, një shkollë dhe një kompleks spitalor.
2. Burrat falen jashtë xhamisë Dar al Islam afër Abikuisë, Nju Meksiko.
3. Gjatë një shërbese faljesh në Shoqatën Myslimane të Memfisit në Tenesi.



4



4. Një mysliman përkulet për faljen e pasdites në Medison Avenu në Manhatan, Nju Jork, përpara fillimit të Paradës në Ditën e Unionit Mysliman Amerikan.
5. Vëllazëria Bawa në një xhami në Filadelfia.

5

Xhamitë Amerikane

Sipas një studimi të kryer në fund të viteve 1990, në SHBA ekzistojnë mbi 1 200 xhami dhe qendra islamike, por si xhami të mirëfillta janë projektuar më pak se 100. Studimi vë në dukje se shumica e kongregacioneve islamike në Shtetet e Bashkuara kanë filluar në ndërtesa të ndërtuara për qëllime të tjera si stacione zjarrfikësish, teatro, depo apo dyqane.

Megjithatë, pas vitit 1965, me fluksin e madh të myslimanëve që erdhën në SHBA nga vende të ndryshme, gjendja ndryshoi. Xhamitë filluan të ndërtoheshin vetëm me qëllim që t'i shërbenin bashkësisë myslimane si shtëpi faljeje dhe si qendra të bashkësisë. Larmia e madhe fetare dhe etnike e myslimanëve amerikanë në ditët e sotme pasqyrohet në larinë e modeleve dhe të projekteve të ndërtesave.

Fotografi dhe dokumentaristi i arkitekturës së xhamive, Dr. Omar Khalidi, një studiues i vjetër në Programin Aga Khan të Arkitekturës Islamike në Institutin Teknologjik të Masaçusetsit në Kembrixh, bën një analizë mbi tre tipat e arkitekturës së xhamive që lulëzojnë sot në Shtetet e Bashkuara.

«Së pari, kemi xhamitë që mishërojnë një model tradicional të transplantuar nga një apo disa treva islamike», vë në dukje Dr. Khalidi. «Së dyti, kemi xhamitë që përfaqësojnë një riinterpretim të traditës, nganjëherë e kombinuar me elemente të arkitekturës amerikane. Së treti, kemi edhe modelet që janë tërësisht risore, si ato të selisë së Shoqatës Islamike të Amerikës së Veriut në Plainfield, Indiana.

Shumica e xhamive që bëjnë pjesë në këto tri kategori funksionojnë edhe si klasa, biblioteka, salla konferencash, librari, kuzhina, mjedise takimesh shoqërore, madje edhe si apartamente banimi.

Një faktor tjetër i rëndësishëm në arkitekturën e xhamive është mjedisi për lutjet e grave. Në Amerikë, gratë përgjithësisht janë pjesë integrale e veprimtarive të xhamive dhe luajnë një rol aktiv në bashkësinë myslimane. Në një familje tipike myslimane amerika-



1. Pamje e Qendrës Islamike në Ivënsvil, Indiana.

Ndërtesa ka elemente tipike të arkitekturës periferike mesperëndimore.

2. Hapësira e brendshme e Qendrës Islamike në Ivënsvil, Indiana.

3. E ndërtuar më 1979, ndërtesa e Shoqatës Islamike të Amerikës së Veriut në Plainfield, Indiana, ka një stil të rreptë ku xhamia, biblioteka dhe zyrat brenda saj formojnë një tërësi të unifikuar.




3



ne, e gjithë familja merr pjesë në falje duke bërë të nevojshme një mjedis për gratë, zakonisht në një kat mesak.

Në shumë raste, arkitektura e xhamive në Amerikën e Veriut pasqyron modelet tipike të ndërtesave të

kësaj zone. «Me kohë do të zhvillohet një model standard, që do të jetë një shkrirje e harmonishme mes nostalgjisë dhe risisë», parashikon Dr. Khalidi. «Xhamitë e reja që po ndërtohen në Perëndim nuk janë kurrësi thjesht një kube dhe një minare.» ★



1. Një xhami më tradicionale me kube dhe minare në Tempe, Arizona.
2. Qendra Islamike në Kaliforninë Jugore në Bevërli Hills.
3. Shoqata Islamike e Hjustonit metropolitan, Teksas, e ndërtuar në fillim të viteve 1990.
4. Në Pullman, Uashington, një minare tradicionale hijeshon Qendrën Islamike.
5. Pamje e brendshme e Xhamisë së Kombit të Islamit në Çikago, Illinois.



6



7




8

6. Modeli risor i Qendrës Islamike në Albukërki, Nju Meksiko, merr në konsideratë mundësitë e gjeografisë, hapësirës, strukturës dhe materialit.
7. Që nga përfundimi i saj më 1991, Qendra Kulturore Islamike është si një monument në qendër të qytetit të Nju Jorkut.
8. Një anëtar i Qendrës Kulturore Islamike në Uashington, D.C., pushon pas shërbesës së të Premtes për të kundruar interiorin e bukur të modelit tradicional.



1



2



3

1. Marinarët e Flotës së SHBA të besimit islamik luten në anije në ditën e parë të Ramazanit më 2001.
2. Një mysliman i devotshëm lexon Kuranin në një nga xhamitë më të mëdha të qytetit të Nju Jorkut në natën e parë të Ramazanit, festa njëmuajore e agjërimit dhe pastrimit.
3. Në South Mauntin, Arizona, një mysliman përjeton një çast sublim me të shoqen teksa të dy shikojnë hënën e re që sinjalizon fillimin e Ramazanit.



4. Ramazani festohet në forma të ndryshme në të gjithë Amerikën. Agjërimi gjatë ditës është vetëm një pjesë e veprimtarive të Ramazanit. Në shumë e shumë shtëpi myslimane dhe xhami në Amerikë, myslimanët mbledhen për të prishur agjërimin e ditës duke ftuar në mbrëmje miq myslimanë e jomyslimanë. Këtu, një familje në Miçigan është gati për prishjen e agjërimin.

4



5



6

5. Presidenti Bush, në qendër, dëgjon Imam Abdullah Muhamed Al-Khouxin, majtas, duke mbajtur një lutje përpara fillimit të darkës së Iftarit në Sallën e Darkave të Shtetit në Shtëpinë e Bardhë të hënën, 19 nëntor 2001, në Uashington D.C. Në tryezë, djathtas, është edhe Sekretari i Shtetit Kolin Pauell.
6. Në një shkollë të mesme në San Fransisko një grua myslimane mban një ligjëratë mbi kuptimin dhe mbajtjen e Ramazanit, muaji më i shenjtë në kalendarin mysliman.



1



2



4



3

1. Dr. Leila Hadad duke ekzaminuar një paciente në qendrën shëndetësore të bashkësisë në Diërborn, Miçigan.
2. Një dyqanxhi ndjek porositë për dyqanin në Frimont, Kaliforni, një zonë ku jetojnë në bashkësi mbi 60 000 afganë.
3. Një shofer taksie në qytetin e Nju Jorkut, mysliman nga Pakistani, thotë se lutjet pesë herë në ditë e lehtësojnë nga streset e punës.
4. Pronari i një kompanie pijesh në Bruklin, Nju Jork, ekspozon një linjë produktesh.



5

5. Punonjës sociale mbledhen jashtë një qendre të përkrahjes sociale në Bruklin, Nju Jork.
6. Në Këlambës, Ohaio, një grua myslimane punon në ambalazhim në një qendër për shpërndarjen e ushqimeve.



6

Besimet dhe Sistemi Bankar

Nga Sheryl Jean

Abdirzak Bill nga Minneapolis, një mysliman i devotshëm, ngurroi shumë përpara se të niste një shërbim të vogël transporti me autobus. Për ta vënë në vijë biznesin ai kishte nevojë për një hua, por ligji islamik tradicional e ndalonte që të paguante interes, ose *reba*, për huan e marrë.

Deri kohët e fundit opsionet kanë qenë të kufizuara për biznesmenët si Billi. Por në maj, për shkak të përpjekjeve të reja nga grupet e Tuin Sitis, Billi pati mundësi të siguronte një financim pa interes për firmën e tij, e cila transporton imigrantët në mësimet e anglishtes.

Billi bleu një autobus shkollë 34-vendësh për 15 000 dollarë që i mori hua nga Qendra për Zhvillimin Vendor në St. Pol. Qendra planifikon të marrë 2 000 dollarë nga fitimet e Billit si shlyerje e borxhit. Billi nuk paguan interes, por qendra prapë merr një të ardhur vjetore për arsye se fitimi ka zëvendësuar interesin.

«Unë më mirë pranoj të dal nga biznesi, se sa të paguaj interes,» thotë Billi. Pa këtë financim alternativ atij do t'i ishte dashur ose të kursente para për të blerë autobusin, ose të përpiquej të gjente borxh pa interes të miqtë.

Vitin e kaluar myslimanët e Tuin Sitisit punuan për t'u shpjeguar zyrtarëve të qeverisë, huadhënësve dhe liderëve qytetarë nevojën për të harmonizuar besimet islamike me financimet alternative.

Bankat thonë se rregullat e forta i pengojnë që të plotësojnë nevojat e myslimanëve. Myslmanët dhe liderët financiarë pajtohen se kjo nuk është thjesht një çështje vetjake ose fetare; ajo është një preokupim sa ekonomik, aq edhe i bashkësisë. Ata thonë se mungesa e fondeve të mjaftueshme i ka ngadalësuar përpjekjet sipërmarrëse dhe e ka penguar zgjerimin e biznesit në Tuin Sitis. Disa thonë se kjo mungesë fondesh i ka penguar myslimanët që ta zgjerojnë pasurinë e tyre, gjë që ka ulur ritmin ekonomik në rajon.

Në shkallë kombëtare, bashkësia islamike po rritet në madhësi dhe mirëqenie. Sipas revistës *Islamic*

Horizons, 6 milionë myslimanë që jetojnë në SHBA (nga 1,2 miliardë në botë) kanë të ardhura vjetore për frymë që variojnë nga 35 000 në 45 000 USD, shifra që janë shumë më të larta se mesatarja kombëtare prej 24 000 në 27 000 USD.

Vlerësohet se në Tuin Sitis jetojnë 75 000 myslimanë (nga rreth 45 000 pesë vjet më parë), kurse në Minesota jetojnë 100 000.

Grupet jofitimprurëse janë njohur me nevojën e myslimanëve për financime alternative gjatë mësimetve të kualifikimit për biznesin, veçanërisht tek imigrantët e rinj nga Somalia, të cilët priren që ta respektojnë më rigorozisht fenë islamike. Në Minesota ndodhet numri më i madh i refugjatëve somalezë që mendohet të jenë rreth 40 000 vetë.

Në fillim të këtij viti, drejtori ekzekutiv i Qendrës për Zhvillimin Vendor në St. Pol, Majk Temal, nisi programin e Investimeve pa Interes për të financuar biznesin e vogël. Këtë e bëri kur pa se imigrantët myslimanë kishin vështirësi për të nisur një biznes ngaqë nuk gjenin dot hua.

Kohët e fundit janë ndërmarrë një sërë programesh vendore islamike ose janë në stadet e planifikimit.

- Korporata Filips për Zhvillimin e Bashkësisë dhe Agjencia për Zhvillimin e Bashkësisë në Minneapolis kanë financuar një pronar islamik biznesi sipas mënyrës në të cilën pagesat administrative zëvendësojnë interesin. Të dyja këto agjenci kërkojnë mënyra për t'i bërë programet të pranueshme për më shumë myslimanë të devotshëm.
- Konsorciumi i Zhvilluesve të Bashkësisë në Minneapolis ka bërë dy financime mbi bazë pagesash në dobi të bizneseve islamike në kuadrin e një programi pilot. Ky grup jofitimprurës synon që brenda dy vjetësh të themelojë një fond kapital për biznesin e vogël, i cili do të plotësonte nevojat e myslimanëve dhe të tjerëve. Ai po shqyrton edhe opsione të tjera financimi.



- Për të shitur vetura dhe për t'u dhënë klientëve financime pa interes, vitin e kaluar u hap një biznes makinash të përdorura me emrin Dalsan Auto Dealer, pronë e një somalezi.
- Në shkallë vendi, disa kompani si American House Finance Lariba dhe MSI Financial Services u ofrojnë vetura dhe pajisje me qira si dhe financime pa interes për shtëpitë dhe bizneset njerëzve që banojnë në Minesota. Disa përpjekje vendore po përqendrohen edhe në drejtim të pronësisimit të banesave nga myslimanët.
- Një grup në Tuin Sitis po punon për të formuar një union krediti islamik.
- Banka të tilla si Wells Fargo & Co. dhe University Bank po shqyrtojnë mundësinë për të ndihmuar bizneset islamike dhe për të nxitur pronësinë e banesave.

«Ekziston një nevojë e madhe për ta bërë këtë,» thotë Uafik Fanoun, një konsulent pranë shumë grupeve jofitimprurëse dhe bankave në Tuin Sitis mbi mënyrat se si mund t'u sigurohen financime islamikëve. «Bashkësia myslimane në Tuin Sitis i ka filluar përpjekjet për këtë qysh prej dhjetë vjetësh.»

Një marrëveshje financiare pa interes me Qendrën e Zhvillimit Vendor në St. Pol, Minesota, i jep mundësi këtij myslimani që të paguajë blerjen e një furgoni dhe pajisjet e duhura për biznesin e shpërndarjes së ushqimeve nëpër shtëpi dhe lokale në zonën e Tuin Sitisit.

«Shumë myslimanë në Minesota nuk kanë rrugë tjetër veçse të gjejnë hua bankare tradicionale. Ne të gjithë e bëjmë këtë nga halli. Ky është sistemi. Unë nuk mund ta ndryshoj atë, por ky është një fillim.»

Hamdi El-Sauaf, drejtor ekzekutiv i Qendrës Islamike në Minesota thotë se Islami është feja që po përhapet më shpejt në botë, por myslimanët luftojnë akoma për një mirëkuptim social më të madh.

Sheryl Jean është reportere për biznesin pranë Pioneer Press, një gazetë në St. Paul, Minesota.

*Kopirajti © 2001 PioneerPlanet / St. Paul (Minnesota)
Pioneer Press / TwinCities.com.*

INTERES I NDALUAR

Myslimanët nga Afrika, Azia, India, Lindja e Mesme dhe Evropa Lindore ushtrojnë një fe të themeluar 1 400 vjet më parë. Ligji islamik Sheriah mbështetet në Kuran, në librin e shenjtë të Zotit që përmban mësimet e Profetit Muhamet.

Ligji islamik e ndalon rreptësisht dhënien apo marrjen e interesit. Myslimanët besojnë në ruajtjen e harmonisë ekonomike në çdo transaksion financiar. Nuk është e pranueshme që një person i pasur të përfitojë duke i dhënë hua para një personi tjetër më pak të pasur. Paraja ndahet dhe kjo përbën një mënyrë për të ndihmuar përparimin e bashkësisë.

Ky besim ndikon në mënyrën se si një mysliman financon një shtëpi, veturë apo shkollim, se si e fillon ai një biznes, si i paguan faturat dhe si i përdor kartë-kreditet.

Pagimi i interesit është herë një pengesë e madhe, herë e vogël, në varësi se sa i devotshëm është një mysliman. Shumë myslimanë tradicionalë në Tuin Sitis nuk zotërojnë shtëpi ose nuk kanë llogari kursimesh në bankë. Nëse kanë librezë kursimi, zakonisht interesin e japin për bamirësi.

Marrëveshjet financiare të pranueshme në bazë të ligjit islamik përfshijnë marrëveshjet e blerjes/shitjes dhe blerjes/qiradhënies, huatë pa interes, kontratat kosto-plus-fitim, investimet në aksione dhe ortakëri.

Osman Aliu përfitoi nga një marrëveshje shitblerjeje kur filloi një biznes për shpërndarjen e rreth 400 racioneve ushqimore në javë dhe për sigurimin e ushqimeve për restorantin Tarik në Mineapolis, pronë e një somalezi. Në vitin 1995, Qendra për Zhvillimin Vendor kishte blerë një automjet të tipit Dodge Caravan dhe disa pajisje, të cilat ia shiti Aliut për 5 323 USD me këste mujore prej 443,64 USD për një vit.

Por myslimanë të tjerë në Tuin Sitis, që përballen me opsione më të pakta, përdorin kursimet dhe mbështet-



Ligji mysliman ndalon dhënien ose marrjen e interesave, kështu që për të blerë ose shitur pronë mund të jetë e vështirë. Gjithsesi ky djalosh po pret që të diskutojë me të atin në Afrikën Lindore disa informacione biznesi nëpërmjet e-mail-it.

jet te bujaria e familjes dhe e miqve, gjë që e kanë bërë edhe grupe të tjera imigrantësh. Disa të tjerë, veçanërisht në bashkësinë somaleze, i grumbullojnë paratë si grup duke vepruar pak a shumë si një klub investimesh.

Një prej tyre është Halime Jusufi, e cila një vit më parë hapi një dyqan veshjesh të quajtur Gruaja e Bukur në mini-marketin somalez Karmel Souk në Mi-

neapolis. Halimeja, ortaku i saj somalez dhe pronarët e katër dyqaneve të tjerë formuan një fond financiar: çdo dyqan kontribuon me 1 000 USD në muaj dhe njëri nga pjesëtarët merr 5 000 USD. Muajin tjetër shumën prej 5 000 USD e merr një dyqan tjetër derisa të gjithë e marrin fondin. Kjo gjë përsëritet.

Jusufi i fut në punë paratë që merr pa interes për të furnizuar dyqanin e saj me veshje, artikuj kozmetikë dhe shtëpiakë që i merr nga Çikagoja, Nju Jorku apo nga jashtë. Po për të dalë pa humbje, apo për t'u zgjeruar, ajo ka nevojë për më shumë para për të blerë mallra.

«Përgjithësisht bashkësitë e imigrantëve janë shumë krijuese dhe prirën që të marrin para nga familjet e tyre tradicionale të mëdha dhe nga të afërmit», thotë Ed Lambert, drejtor ekzekutiv i Konsorciumit të Mineapolisit, një shoqatë korporatash jofitimprurëse për zhvillimin e bashkësisë në zonën e Mineapolisit. «Por shumë (myslimanë) nuk kanë familje të mëdha tradicionale që do t'u siguronin përkrahjen e duhur.»

Duke kërkuar financime nga burime të tjera, myslimanët mund të ndeshen me pengesat e ligjeve të shtetit dhe federale. Përveç kësaj, shumë grupe jofitimprurëse që përpiqen t'i ndihmojnë ata mund të përballen vetë me probleme financimi.

Për shembull, myslimanët nuk arritën të futeshin në programin e Qendrës për Zhvillimin Vendor në fillim të këtij viti ngaqë asaj i qenë mbaruar fondet. Qendra kishte pasur marrëdhënie bankare për marrje parash nga Programi i Nismës Qytetëse të Departamentit të Tregtisë dhe Zhvillimit Ekonomik të Minesotës, por ndeshi në një pengesë ligjore. Ligji i shtetit ndalon që fondet e huasë shtetërore të përdoren për të blerë pajisje dhe për t'ia dhënë ato me qira një biznesi, thotë Bart Bevins, i cili administron Programin e Nismës Qytetëse.

Bevinsi mendon se vitin tjetër mund të propozohet një amendament legjislativ. Nga ana tjetër, muajin e kaluar, Qendra për Zhvillimin Vendor mori një grant pa interes prej 100 000 dollarësh nga Fondacioni i Mineapolisit dhe shpreson të marrë edhe nga burime të tjera.

BANKAT REZERVohen

Përpjekjet për financimin e myslimanëve në Tuin Sitis janë meritë e grupeve jofitimprurëse, jo të bankave, sepse bankat thonë se u përmbahen rregullave. Që të ndryshohen rregullat për t'iu përshtatur nevojave të myslimanëve do të duhej të ndryshohej rrënjësisht industria bankare, e cila zakonisht i adopton me vonesë rrisitë.

«Ky është një territor i ri për rregulluesit», thotë Devid Reiling, president i Bankës së Universitetit në St. Pol. «Ata nuk do të shpikin ndonjë gjë, por as nuk thonë se kush mund ta bëjë këtë. Nëse dikush e bën dhe nëse nuk ka ndonjë shkelje flagrante, ata duhet ta monitorojnë nga afër për të parë se si funksionon.»

Bankat e kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre për grupet etnike hispanike dhe aziatike, por financimi i islamikëve përbën një risk më të madh, pasi ai kërkon një strukturë të re financiare, jo thjesht shtimin e një emri të ri në një listë të vjetër. Mafi Gebler, zëvendës-president i Wells Fargo, e cila merret me zhvillimin e bashkësisë për rajonin e Miduestit, vë në dukje se «Kjo është diçka që duhet ta kemi parasysh dhe ta trajtojmë, pasi këto janë tregje në lindje e sipër... dhe përbëjnë një pjesë në rritje në kontingjentin e klientëve tanë.»

Përpjekjet për krijimin e Unionit Islamik të Kreditit të Minesotës që po i ndërmerr një grup myslimanësh për ndërtimin e një sistemi financiar brenda kërkesave islamike mund të konsiderohen si përgjigje ndaj vështirësive financiare me të cilat po ndeshen myslimanët. Ai do të ishte unioni i parë islamik i kreditit në vend.

Ky grup, i cili po punon shumë për sqarimin e myslimanëve se ç'është një union krediti, po mbledh zotime për grumbullim fondesh. Fevzi Auad, një nga organizatorët e grupit, thotë se në fillim të këtij viti ai hapi një sajt në Internet në www.icumn.org dhe ka shtypur pamflete edukative për t'i shpërndarë gjatë aktiviteteve islamike. Grupi synon që propozimin për unionin e kreditit t'ia bëjë shtetit qysh këtë vjeshtë, por nuk ka rënë dot në kontakt me agjencitë rregulluese të shtetit dhe federale.

«Ne nuk duam të dukemi sikur po themelojmë diçka ndryshe nga norma,» thotë Auadi, «por duam të krijojmë diçka në të cilën besojmë. Kështu do të zgjidhnim disa nga çështjet me të cilat përballemi në shoqëri.» ★

NË FJALËT E PRESIDENTIT XHORXH U. BUSH



THIRRJE PËR RESPEKT

Kur mendojmë për Islamin, ne mendojmë për fenë që u sjell qetësi shpirtërore një miliard njerëzve në të gjithë botën. Miliarda njerëz gjejnë prehje, ngushëllim dhe paqe. Ai i ka bërë njerëzit vëllezër dhe motra nga të gjitha racat. Amerika numëron miliona myslimanë në gjirin e qytetarëve tanë dhe myslimanët i japin një kontribut jashtëzakonisht të çmuar vendit tonë. Myslimanët janë doktorë, avokatë, profesorë të së drejtës, anëtarë të ushtrisë, sipërmarrës, pronarë dyqanesh, nëna dhe baballarë. Dhe ata duhet të trajtohen me respekt. Në zemërimin dhe emocionet tona, bashkëqytetarët tanë amerikanë duhet ta trajtojnë shoqi-shoqin me respekt.»

– Nga Fjala e mbajtur në Qendrën Islamike në Uashington, D.C., fill pas sulmeve të 11 Shtatorit 2001.

I NJËJTI HIDHËRIM

«Është e rëndësishme që bashkëqytetarët tanë amerikanë të kuptojnë se amerikanët e besimit mysliman ndajnë të njëjtin hidhërim si edhe ne për atë çka ngjau në vendin tonë; se ata janë po aq krenarë për Amerikën sa ç'jam edhe unë krenar për të; se ata e duan vendin tonë sa ç'e dua edhe unë. Ata ndajnë besimin tim të thellë se asnjë amerikan nuk duhet gjykuar nga pamja, nga përkatësia etnike apo nga besimi fetar. Unë e besoj fuqimisht këtë, sikurse edhe ata.»

– Nga Fjala në Ambasadën Afgane në Uashington D.C., 10 shtator 2002.

URIM ME RASTIN E BAJRAMIT

«Urime të përzemërta myslimanëve në të gjithë Shtetet e Bashkuara ndërkohë që ju festoni festën e Kurban Bajramit dhe bashkoheni shpirtërisht me milionat që janë mbledhur në Mekë për të mbajtur lart traditat e festave tuaja më të shenjta. Amerika është ndërtuar mbi një truall fetar të fortë dhe kremtimi i fesë është qendror në jetën tonë. Ndërsa ju kremtoni Haxhiun e përvitshëm, shtyllën e pestë të Islamit, ju nderoni sakrificën dhe devotshmërinë e madhe të Abrahamit, siç njihet nga Judeizmi, Krishterimi dhe Islami. Duke edukuar të tjerët për traditat tuaja fetare, ju pasuronit jetën e të tjerëve në bashkësitë tuaja vendore. Larmia e kombeve dhe e kulturave, e përfaqësuar nga ata që shkojnë në Mekë çdo vit, dhe format e larmishme në të cilat myslimanët kontribuojnë në jetën amerikane nëpër Shtetet e Bashkuara, janë përkujtues të fuqishëm se ndryshimet etnike dhe racore nuk duhet të na ndajnë kur kemi qëllime dhe vlera të përbashkëta. Duke ndërtuar themele të shëndosha të respektit reciprok, ne mund të arrijmë paqen dhe pajtimin në botën tonë. Laura bashkohet me mua në dërgimin e urimeve më të mira për një kremtim të gëzuar të ditës së shenjtë.»

– Mesazh me Rastin e Bajramit

«Këtu jam imigrant; toleranca dhe mbështetja që kam gjetur është me të vërtetë e mrekullueshme.»

– Dr. E. Zerhuni, Drejtor i Institutit Kombëtar për Shëndetin



«Ideja se shkenca mund të përmirësojë shëndetin është pohuar në Islam që prej shumë shekujsh. Ekziston një bindje e thellë se nëpërmjet dijeve njeriu mund të përmirësojë jo vetëm mjekësinë, por edhe fatin e vet.

Jam lindur në Algjeri, në një qytet të vogël të quajtur Nidroma. Më tërhoqi shumë mjekësia, pasi kam një dajë radiolog.

Erdha në Amerikë në vitin 1975 dhe të gjithë më thoshin: «Xhons Hopkins është Meka e vërtetë e mjekësisë; nëse do të arrije të shkoje atje, do të përfitoje shumë.» U pritja me ngrohtësi nga njerëzit e atjeshëm, nga profesorët. Ata më thoshin: «Këtu jemi të gjithë imigrantë, vijmë nga vende të ndryshme, por jemi shkruar së bashku.»

Instituti Kombëtar i Shëndetit ka për mision që të çojë përpara njohuritë mbi kujdesin shëndetësor dhe sëmundjet që prekin njerëzimin. Këtu, në Uashington, punojnë 18 000 vetë, por Instituti financon 45 000 projekte në të gjithë botën.

Kur realizojmë një vaksinë, ajo vihet në përdorim në të gjithë botën. Kur krijojmë një trajtim të ri, ai është në dispozicion në të gjithë botën. Kështu ne ndikojmë mbi shëndetin e çdo njeriu në botë.

Unë jam emëruar në këtë post nga presidenti Xhorxh Bush dhe jam konfirmuar nga Senati i SHBA. Ajo që do t'ju thosha myslimanëve në të gjithë botën është: unë nuk besoj se ka ndonjë vend tjetër në botë ku njerëz të ndryshëm nga vende të ndryshme të pranohen dhe të mirëpritën si anëtarë të shoqërisë dhe si qytetarë të mirë.


1



3



2



4

1. Më 15 nëntor 2001, ditën e fundit kur Dhoma është e mbledhur përpara Ramazanit, Imam Jahjai bën lutjen hapëse në Dhomën e Përfaqësuesve. Kryetari i Dhomës Denis Hastert dëgjon me kokën të ulur.
2. Imam Abdyl-Rashid Muhamed bëhet kapelani i parë mysliman i Ushtrisë. Emërimi i tij që përgjigje ndaj rritjes së numrit të myslimanëve në ushtri ose që konvertohen në këtë fe në ushtri.
3. Më 19 shtator 2001 presidenti Xhorxh Bush takohet në Shtëpinë e Bardhë me presidentin indonezian Megawati Sukarnoptri, kryetari i vendit mysliman më të populluar të botës.
4. Një rreshter në ushtri lexon një libër lutjesh përpara një shërbese në Qendrën Shëndetësore Ushtarake në Uolter Rid, Uashington D.C.



5. «Eid mubarak» ose «Qoftë e bekuar festa juaj fetare» është mesazhi në pullën postare të Bajramit që nderon dy festat e rëndësishme myslimane. Shërbimi Postar i SHBA e nxori këtë pullë më 1 shtator 2001 në kuvendin vjetor të Shoqatës Islamike të Amerikës së Veriut.



Repi Mysliman

I NATIVE DEEN

Nga Phyllis McIntosh

Tingulli i tyre është një rep rrugë i njohur dhe aq shumë popullor tek adoleshentët amerikanë. Por mesazhi është shumë më optimist se temat e errëta të drogës dhe të dhunës që përshkojnë shumicën e repeve. Ja fjalët e një kënge me titull «Synimet».

«Synimet e mia nuk mund të sjellin shpërblim kur janë jashtë normës.



Nëpërmjet stilit rep që është krejtësisht amerikan dhe i pranueshëm për të gjitha grupet, këta tre djem të rinj nga zona e Uashington D.C. frymëzojnë myslimanët e rinj për të ushtruar fenë e tyre.

Kështu që i lutem Allahut të më ndihmojë që të bëj gjithçka vetëm për të.»

I njohur si repi mysliman, kjo dukuri e re muzikore është sidomos në shijen e afro-amerikanëve që përbëjnë një të tretën e të gjithë myslimanëve në Shtetet e Bashkuara. Grupi që e përdor këtë ritëm është Native Deen: tre zezakë të zonës së Uashington

D.C., që janë rritur si myslimanë të devotshëm dhe duan t'i përdorin talentet e tyre për të frymëzuar të rinj të tjerë për të ruajtur fenë e tyre në mes të trysnive dhe tundimeve të jetës moderne.

Të tre – Xhoshua Selam, 28 vjeç, Naim Muhamet dhe Abdyl-Maliq Ahmet, nga 26 vjeç – janë të martuar dhe me fëmijë të vegjël. Kur nuk merret me muzikë, Selami drejton sektorin e të drejtave civile të Këshillit për Marrëdhëniet Amerikano-Arabe, Muhameti punon në një kompani të teknologjisë së informacionit, kurse Ahmeti krijon sajte në ueb dhe jep mësimë në shkencat ushtarake.

Si grupi Native Deen, ata japin shfaqje në konferenca islamike, në takimet e njerëzve që grumbullojnë fonde, në dasma e festa dhe në çdo vend për të cilin thonë se «ka nevojë për argëtimin e shëndetshëm islamik». Ata u qëndrojnë larg klubeve, bareve, disko apo çdo lokali ku nuk zbatohen ndalimet e Islamit për alkoolin, vallzimin dhe shumë forma të muzikës. Shumica e këngëve të tyre trajtojnë rritjen si mysliman në Amerikë, të kujtuarit për të bërë lutjet e mëngjesit dhe për të ushtruar fenë pa u kapur pas zotërimeve materiale dhe «shfaqjeve në TV apo videove muzikore». Disa pjesë të tyre janë thjesht thirrje drejtuar dëgjuesve që t'u rrinë larg drogës, seksit ose kopjimit në shkollë pa e përmendur konkretisht fenë e dëgjuesit.

Grupi bën kujdes që të kompozojë lirika të pranueshme edhe për veshët shumë të ndjeshëm të prindërve. «Ne bëjmë kujdes që të mos fusim në këngët tona fjalë që nuk do të donim t'i përsërishte një fëmijë 4-vjeçar», thotë Selami, drejtuesi i grupit. «Muzika jonë është e tillë që mund të shijohet bashkarisht nga prindërit dhe fëmijët. Madje vetë prindërit i nxitin fëmijët që ta dëgjojnë.

Meqenëse shumë myslimanë besojnë se mësimet e profetit Muhamet ndalojnë shumë instrumente muzikore, Native Deen përdor daullet tradicionale në shfaqjet live. Videot dhe CD-të e tyre përfaqësojnë një larmi të madhe instrumentesh me perkusion, kështu që një mesazh në fillim të koncertit i siguron dëgjuesit se ata nuk do të dëgjojnë instrumente fryme ose me tela që konsiderohen tabu në mënyrë të veçantë.

Në vitin 2000, shumë kohë pasi kishin dhënë shfaqje së bashku apo veç e veç në kampet e të rinjve të Amerikës së Veriut (MYNA) dhe në aktivitete të tjera islamike, të tre muzikantët formuan grupin Native Deen. Ata dhe artistët të tjerë kanë regjistruar një sërë videokasetash të quajtura MYNA-RAPS, shitjet e

të cilave ndihmojnë në mbështetjen e veprimtarive të të rinjve myslimanë. «Kur filluam të udhëtojmë dhe të interpretojmë rregullisht së bashku, ne vendosëm që t'i vinim një emër grupit tonë, «thotë Selami. «Deen në arabisht do të thotë fe ose mënyrë jetese, kështu që zgjodhëm emrin Native Deen për të simbolizuar fenë që është e lindur bashkë me ne.»

Gërshetimi i repit me temat myslimane nuk ka qenë një vendim i vetëdijshëm, thotë Selami. «Përvojat tona kanë të bëjnë me rritjen si mysliman dhe zezak në Amerikë. E natyrshme është ajo që del nga buzët tona.»

Fjalët e gojës kanë mjaftuar për t'i çuar muzikantët e rinj në turne në veprimtari islamike në Kaliforni, Teksas, Illinois – madje morën ftesë edhe për në Angli, por u detyruan që ta refuzonin për shkak të një angazhimi të mëparshëm. Kur një ekip televiziv nga Malajzia shkoi në Shtetet e Bashkuara dhe bëri një emision për ta, ata bënë për vete edhe simpatizantë në Malajzi.

Gjatë muajve të fundit fama e tyre është rritur falë një emisioni në radio me titull «Në Skenë me Native Deen» që transmetohet çdo të premte në mbrëmje në një radio vendore islamike dhe që transmetohet në të gjithë botën nga Islamic Broadcasting Network (IBN) Web site. Ky program i kombinuar me muzikë, me të folur të shpejtë dhe me diskutime live, ka qenë «shumë i suksesshëm në tërheqjen e masave të të rinjve» kryesisht studentë të shkollave të mesme dhe kolegjeve, thotë drejtori i programeve të IBN, Soahib Elsaid. Artistët «përcjellin personalitet dhe janë tërheqës» thotë ai. «Ata trajtojnë çështjet e rritjes si mysliman në Amerikë duke i paraqitur ato në një dritë më gazmore.»

Selami thotë se vlerësimet që grupi merr nga të rinjtë simpatizantë është veçanërisht ngazëllyes.

«Njëri vjen e na thotë se si një këngë e ka ndihmuar për të ecur më mirë në mësimet në klasën e nëntë, një tjetër se si ajo e ka frymëzuar për të arritur synimet e tij duke i kujtuar besimin te Zoti dhe se Zoti ekziston – dhe e gjitha kjo e dhënë në mënyrë argëtuese.»

Ai shton se nëpërmjet Native Deen myslimanët në Shtetet e Bashkuara ndiejnë gjithashtu se kanë diçka të vetën. Ata mund të bëjnë argëtime në veprimtari të tyre që nuk ka pse të jenë në arabisht. «Muzika jonë është amerikane, e kohës, diçka me të cilën të gjithë e ndiejnë veten të familjarizuar», thonë ata. ★

Shansi Juaj për t'u Dëgjuar

Ç'do të donit t'i thoshit popullit amerikan?

Lutemi shkruani këtu mendimet, sugjerimet dhe pyetjet tuaja.

E prisni këtë pjesë dhe e dërgoni në adresën më poshtë:

SURVEY RESPONSE

P.O. Box 1677
JKS 12016
Indonesia

ose

SURVEY RESPONSE


IIP/T/CP, SA-44
U.S. Department of State
Washington, DC 20547

Përgjigjet me e-mail në: **IPTCP@pd.state.gov**

Një mesazh nga Këshilli i Myslimanëve Amerikanë për Mirëkuptim dhe nga Populli Amerikan.

e prisni këtë





Kjo nxënëse dhe shoqja e tij e klasës në Morton Grouv, Ilinois, mund të zgjedhin shumë burime leximi dhe studimi për fëmijët myslimanë të lindur në Amerikë dhe që flasin anglisht.

Titrat e Fotove:

Ballina: Jim Blair. Tryeza e Lëndës: Faqe e majtë, Jim Blair; North Wind Picture Archives; The Fresno Bee. 1: © Wolfgang Hoyt/Esto/Architect Skidmore, Owings & Merrill; © 1999 Joseph Rodrigues/Black Star; Me kortezinë e Native Deen. 2: AP/Wide World Photos; Sheila Springsteen/CORBIS/Sygma; AP/WWP. 3: James Kemp/Black Star. 4–8: Jim Blair (11). 10: Sheila Springsteen/CORBIS/Sygma; AP/WWP (3). 11: Jeff Christensen/REUTERS/TimePix; AP/WWP (3). 12: Chris Anderson/Aurora; AP/WWP; © David H. Wells/CORBIS. 13: © 1999 Joseph Rodrigues/Black Star; Jeff Christensen/REUTERS/TimePix. 14–15: North Wind Picture Archives. 16: AP/WWP. 17: © Hulton Archive; AP/WWP. 19: Grafika e mbështetur mbi informacionin nga Hartford Institute for Religious Research. 20–21: Min-Chih Yao (2). 22: Boston Herald. 24: The Christian Science Monitor; AP/WWP. 25: AP/WWP. 26: Ribotuar me leje, Globe Newspaper Company Inc. (2). 27: The Christian Science Monitor. 28: Steve Liss/TimePix; © Monika Graff/The Image Works. 29: Me kortezinë e Islamic Horizons; © Monika Graff/The Image Works; Kathleen Burke/Saudi Aramco World. 31: The Fresno Bee; Rick Loomis/Los Angeles Times Photo. 32: Luis Sinco/Los Angeles Times Photo.

33: Rick Loomis/Los Angeles Times Photo. 34: McCann-Erickson (4). 35: Grafika e mbështetur mbi informacionin nga Hartford Institute for Religious Research. 36: AP/WWP; © Steve Liss/Gamma Liaison; Barry Fitzgerald/U.S. Department of State. 37: AP/WWP; © David H. Wells/CORBIS. 38–39: Me kortezinë e Saudi Aramco World (3). 40: Me kortezinë e Omar Khalidi (2); Scott Alfieri/Gamma Liaison; Me kortezinë e Omar Khalidi; Daniel Laine/CORBIS. 41: Kirk Gittings; © Wolfgang Hoyt/Esto/Architect Skidmore, Owings, & Merrill; Ken Lambert. 42: AP/WWP (2); E përdorur me leje, Pat Shannahan/The Arizona Republic, 11/16/2001. 43: AP/WWP (2); Liz Hafala/San Francisco Chronicle. 44: AP/WWP; Julie Plasencia/San Francisco Chronicle/CORBIS SABA; © 1999 Joseph Rodrigues/Black Star; AP/WWP. 45: © 1999 Joseph Rodrigues/Black Star; AP/WWP. 47–48: Richard Marshall/St. Paul Pioneer (2). 50: Shtëpia e Bardhë. 51: AP/WWP; McCann-Erickson (3). 52: AP/WWP (2); Paul Hsefros/NYT Pictures (2). 53: REUTERS/TimePix. 54: Me kortezinë e Native Deen (2). Kopertina e pasme nga brenda: Kathleen Burke/Saudi Aramco World. Kopertina e pasme: AP/WWP.

REDAKTOR EKZEKUTIV

George Clack

REDAKTOR PËRGJEGJËS

Chandley McDonald

DREJTOR ARTISTIK

Min-Chih Yao

KËRKIMET PËR FOTOT:

Maggie Johnson Sliker

Kërkimet për Fotot JS

John Wicart

PËRKTHYEF:

Stavri Pone

Produced by
Regional Program Office, Vienna
(Muslim Life in America/Albanian)



Një pakistanezo-amerikan lutet në Qendrën Islamike në Uashington, D.C.